



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

2013

RAPORTI VJETOR **2013**

I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
PËR PARLAMENTIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



LISTA E SHKURTESAVE	3
DEKLARATA E KRYETARIT	5
STRUKTURA ORGANIZATIVE	9
AKTIVITETET E AGJENCISË	9
DIVIZIONI I SHITJES	9
DEPARTAMENTI I SHITJES	10
ADMINISTRIMI DIREKT	14
NJËSIA PËR KONTROLL DHE MBIKËQYRJE	21
NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITOR	27
DIVIZIONI PËR KOORDINIM TË LIKUIDIMIT	29
DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUIDIMIT	29
NJËSIA PËR MONITORIM TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA	30
NJËSIA E LIKUIDIMEVE NGA AKP	36
NJËSIA E LISTAVE TE PUNËTORËVE	37
DEPARTAMENTI I KOORDIMIT RAJONAL	43
PRIVATIZIMI	43
LIKUIDIMI	43
SFIDAT	43
DEPARTAMENTI LIGJOR	44
NJËSIA PËR REGJISTRIMIN E ANKESAVE	44
NJËSIA PËR PËRFAQËSIME NË GJYKATË	45
NJËSIA PËR OPINIONE LIGJORE	45
KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË LIS TAVE TË PUNËTORËVE (KSHALP)	46
KOMISIONI PËR SHITJEN E BANESAVE NË PRONËSI TË N.SH-VE	46
NJËSIA PËR RIORGANIZIMIN E TREPÇËS	47
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	51
PASQYRAT FINANCIARE	53
SHTOJCAT	
SHTOJCA 1.3 - LISTA E NDËRMARRJEVE NËN ADMINISTRIM DIREKT SIPAS NENIT 6	
SHTOJCA 1.4 - LISTA E TRANSAKSIONEVE NË PERPUTHJE ME NENIN 8	
SHTOJCA 1.5 - LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA NE PERPUTHJE ME NENIN 9	
SHTOJCA 1.6 - LISTA E NDËRMARRJEVE NË PROCES TË RIORGANIZIMIT	

LISTA E SHKURTESAVE

AD – Administrimi i Drejtpërdrejtë
AL – Autoriteti i Likuidimit
AKP – Agjencia Kosovare e Privatizimit
APIK – Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë
BiD – Bordi i Drejtorëve
CLOR – Rreziqe të caktuara ligjore dhe tjera
DL – Departamenti Ligjor
GP – Grupi Punues
IKAP – Instituti Kosovar për Administratë Publike
KB – Kooperativa Bujqësore
KSHLP – Komisioni për Shqyrtimin e Listave të Punëtorëve
LMFPP – Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MAP – Ministria e Administratës Publike
MBPZHR – Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
MFGJ – Ministria Federale e Financave Gjermane
MISHAL – Memorandum Informimi për Shitje të Aseteve me Likuidim
MZHE – Ministria për Zhvillim Ekonomik
Nder e Re – Ndërmarrje e Re
NJAB – Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJKM – Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje
NJOL – Njësia për Opinione Ligjore
NJPGJ – Njësia për Përfaqësime në Gjykata
NJRA – Njësia për Regjistrimin e Ankesave
NJSHA – Njësia për Shqyrtimin e Ankesave
NSH – Ndërmarrje Shoqërore
OEK – Oda Ekonomike e Kosovës
OSHP – Ofruesi i Shërbimeve Profesionale
DhPGJSK – Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës
SDR – Kërkesë për Përcaktimin e Statusit
SHA – Shoqëri Aksionare
SHAL – Shitja e Aseteve përmes Likuidimit
SHPK – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SORr – Spin Off i Rregullt
SOS – Spin Off Special
ZR – Zyra Rajonale

DEKLARATA E KRYETARIT

I nderuar Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Bordi i drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit paraqet Raportin Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ("AKP") për vitin kalendarik 2013, si obligim i dalë nga neni 20, pika 20.1 të Ligjit për AKP-në i cili përfshin:

- 1.1 Pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë;
- 1.2 Veçmas nga llogaritë e Agjencisë, pasqyrat financiare të llogarive dhe aseteve e cila mbahet nga Agjencia në mirëbesim;
- 1.3 Listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1;
- 1.4 Listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull;
- 1.5 Listën e ndërmarrjeve të likuiduara sipas nenit 9; dhe
- 1.6 Listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit.

Kam kënaqësinë që për vitin 2013 të ju njoftoj se përkundër vështirësive të mëdha AKP-së ka arritur të përshpejtoj ndjeshëm shitjen dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e saj.

Në shkurt të vitit 2013 Kuvendi i Kosovës me emërimet e bëra kishte kompletuar BiD të AKP-së. Megjithatë, gjatë muajit maj të vitit 2013 një anëtar ndërkombëtar dhe dy anëtarë vendorë, (përfshirë Kryesuesin e Bordit) kanë dhënë dorëheqje nga pozitat respektive. Si pasojë e këtyre dorëheqjeve dhe mosplotësimit të tyre nga Kuvendi i Kosovës prej muajit Maj të vitit 2013 e deri në momentin e raportimit, aftësia e Agjencisë për të operuar sipas mandatit të saj ka qenë jashtëzakonisht e kufizuar sa i përket kryerjes së përgjegjësisë dhe të realizimit të planit të punës. Nga muaji maj e deri në fund të periudhës së raportimit Bordi i Drejtorëve funksionon në minimumin e kuorumit të kërkuar me ligj për funksionim. Si rezultat i mosemërimit të anëtarëve në Bordin e Drejtorëve, Agjencia ka pasur kufizime të caktuara që rrjedhin nga neni 14.7 ndërlidhur me nenin 15.2.7 të Ligjit të AKP-së e që ka të bëjë me shfrytëzimin e fondeve në mirëbesim. Lidhur me këtë, Agjencia kishte njoftuar disa herë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare për vështirësitë dhe vonesat me të cilat po përballemi për shkak të përbërjes jo të plotë të Bordit, në veçanti mungesës së anëtarit ndërkombëtarë dhe kemi kërkuar kompletimin e Bordit. Gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme e kemi njoftuar Kuvendin lidhur me sfidat dhe vështirësitë e zbatimit të ligjit të AKP-së si dhe punën shumë të ngadalshme të Odës së Veçantë. Në këtë kontekst ne kemi bërë edhe disa propozime konkrete për ndryshimin e Ligjit të AKP-së me të vetmin qëllim që t'i lëvizim proceset përpara dhe të shpejtojmë përmbushjen e mandatit të AKP-së pa vonesa, ndryshime këto që ende nuk kanë ndodhur.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së gjatë vitit 2013 ishte në këtë përbërje dhe mandate përkatëse:

Blerim Rexha - *Kryesues dhe Drejtor (21.02.2013-16.05.2013), Ka dhënë dorëheqje*

Skënder Komoni - *Zëvendës Kryesues (21.02.2013 – 20.02.2015)*

Dardane Peja - *Drejtor (21.02.2013 – 15.05.2013), Ka dhënë dorëheqje*

Haxhi Arifi - *Drejtor (21.02.2013 – 20.02.2015)*

Maja Milanovic - *Drejtor (21.02.2013 – 20.02.2015)*

Hubert Warsmann - *Drejtor (06.12.2010 – 05.12.2012, riemëruar me 26.06.2012 -31.08.2014)*

Mohammed Omran - *Drejtor (06.12.2010–05.12.2012, riemëruar me 26.06.2012-31.08.2014)*

Bernadette Roberts - *Drejtor (27.08.2012 – 13.05.2013), Ka dhënë dorëheqje*

Michele Moran - *Vëzhgues nga Zyra Ndërlidhëse e Bashkimit European*

Gjatë vitit 2013 Bordi ka mbajtur gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) mbledhje mujore. Çështjet kryesore më të cilat është marrë Bordi gjatë kësaj periudhe kanë qenë: shpërndarja e pjesës së 20% për punëtorët dhe amandamentimi i strategjisë për këtë shpërndarje, likuidimi i përshpejtuar i portfolios së ndërmarrjeve shoqërore, aprovimin e shitjeve të ndërmarrjeve të reja dhe të aseteve të NSH-së.

Në vazhdim gjeni informatat më të hollësishme për aktivitetet sipas mandatit të Agjencisë. Për çfarëdo informate shtesë ne jemi në dispozicion të plotë tuajin.

Skender Komoni



.....
Zv. Kryesues i Bordit të Drejtorëve

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Agjencia funksionon në dy shtylla kryesore: Shitja dhe Koordinimi i Likuidimit që udhëhiqen nga Zëvendës Drejtorët Menaxhues të AKP-së.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtoresha Menaxhuese e Shitjes dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues i Koordinimit të Likuidimit. Agjencia ka departamentet në vijim:

- Departamenti i Financave dhe Buxhetit
- Departamenti e Koordinimit Rajonal
- Departamenti i Shitjes
- Departamenti për Koordinim të Likuidimit
- Departamenti Ligjor
- Departamenti i Administratës; dhe
- Departamentin e Prokurimit Publik.

Agjencia gjithashtu e ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm. Agjencia ka zyrën qendrore në Prishtinë, si dhe pesë (5) zyra rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe tri (3) zyra satelitore (Graçanicë, Shtërpce dhe Leposaviq).

AKTIVITETET E AGJENCISË

Agjencia Kosovare e Privatizimit në portfolion e saj, në fund të vitit 2013 numëron 585 ndërmarrje shoqërore. Gjatë vitit 2013, AKP, ka mbajtur tri (3) valë të privatizimit: Vala 57, Vala 58 dhe Vala 59, dhe pesë (5) shitje të aseteve të ndërmarrjeve në likuidim (SHAL): SHAL 19, SHAL 20, SHAL 21, SHAL 22, SHAL 23. Nga administrimi i AKP-së, që nga fillimi e deri më tani, janë larguar 18 NSH vijim, disa prej tyre janë larguar pasi që janë themeluar mbi prona private, ndërsa disa pas shqyrtimit të statusit dhe sipas ligjit mbi ndërmarrjet publike iu është ndryshuar statusi nga shoqërore në publike dhe disa i janë nënshtruar procesit të transformimit :

1. Gjilan KB Agrobline
2. Gjilan KB Agrodoganaj
3. Gjilan KB Agrofryti
4. Gjilan KB Arbana
5. Gjilan KB Blea
6. Gjilan KB Burimi
7. Gjilan KB Fara

8. Gjilan KB Xhiki
9. Gjilan Barber cooperative
10. Prizren Kosovatransi-Prizren
11. Prizren Nerezina
12. Mitrovice Gornji Ibar Rozaje
13. Mitrovice Kolasingradnja
14. Mitrovice Drvoimpex
15. Mitrovice BVI per Banesa dhe Mbrojtjen e Ambientit
16. Peja Kosovatrans Gjakova
17. Peja Kosovatrans Peje
18. Peja Agjencioni Pyjor

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka përgatitur Raportin Vjetor 2013 të cilin ia ka dërguar Zyrës së Kryeministrit rreth aplikimit të "Ligjit për Qasje në Dokumente Publike". Agjencia gjatë këtij viti ka pranuar 11 kërkesa, prej të cilave 10 kërkesa janë aprovuar/lejuar qasja dhe vetëm një prej tyre është refuzuar me vendim të Bordit të AKP-së. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar në afatin e paraparë ligjor dhe u janë dërguar palëve kërkuuese.

Më 29 Tetor 2013 Agjencia ka nënshkruar memorandumin me Administratën Tatimore të Kosovës lidhur me barrët tatimore të Ndërmarrjeve Shoqërore. Është përgaditur marrëveshja e transferimit të barrës tatimore nga regjistri kadastral në llogarinë bankare të fondeve në mirëbesim dhe është filluar me dy ndërmarrjet e para në Pejë.

SHITJA

Aktivitetet e e Shitjes shtrihen në fushën e organizimit të valëve të privatizimit, shitjen e aseteve me likuidim, realizimin e administrimit të drejtpërdrejtë, vendosja nën kontroll dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të komercializuara apo me kushte si dhe organizimi i publikimeve, marketingut dhe vendosja e marrëdhënieve të mira me investitorë. Rrjedhimisht Departamenti i Shitjes, Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë, Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje si dhe Njësia për Marrëdhënie me Investitorë i raportojnë drejtpërdrejtë Zëvendës Drejtoreshës Menaxhuese të AKP-së e cila është përgjegjëse për menaxhimin e ndërmarrjeve nën autoritetin administrativ të Agjencisë.

DEPARTAMENTI I SHITJES

Në përgjithësi, AKP-ja krijon Ndërmarrje të Reja nga Ndërmarrjet Shoqërore duke ofruar për shitje asetet dhe obligimet aktuale të NSH-ve (të përcaktuara për tre muajt e fundit të llogarive të pagueshme të papaguara dhe vitin e fundit të TVSH-së së papaguar). Në këtë mënyrë mundësohet investimi në asetet kyçe, ndërsa obligimet e N.SH-së trajtohen gjatë procesit të Likuidimit. Ky lloj i shitjes ndryshe njihet edhe si privatizim. Gjatë vitit 2013 janë realizuar tri vale të privatizimit.

Me krijimin e Ndërmarrjeve të reja, investitorët paraqesin ofertë vetëm për asetet e caktuara – dhe vetëm për një numër të kufizuar të detyrimeve aktuale – të NSH-së dhe nuk paraqesin oferta për vetë NSH-në si tërësi. Ndonjëherë AKP-ja ndanë NSH-në në disa Ndër te Reja të vogla, për të siguruar atraktivitet dhe ngritje të vlerës.

AKP-ja gjithashtu bën shitjen e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim, që ndryshe i referohet si Shitja e Aseteve përmes Likuidimit. Në këtë rast nuk ofrohet për shitje Ndërmarrja e Re (asete se bashku me detyrimet e kufizuara) por vetëm asete të caktuara të NSH-së. Gjatë vitit 2013 janë realizuar 5 shitje të aseteve.

AKP-ja lanson valë të shitjeve në mënyrë periodike gjë për të cilën publikon njoftimet në ueb faqen zyrtare të Agjencisë, shtypin ditor vendor, televizionet kombëtare, publikime nëpër portale, dërgon e-mail njoftues palëve të interesit si dhe tërë investitorëve potencial të regjistruar në databazën e saj, në databazat e Odave të ndryshme ekonomike që veprojnë në Kosovë, Agjencinë për Promovim të Investimeve etj.

Te gjitha shitjet janë realizuar me procedure të hapur, konkurruese dhe janë transmetuar drejtëpërdrejtë përmes webfaqes së AKP-së nga salla e kuqe ku janë mbajtur shitjet në internet, në mënyrë që të sigurohet transparenca më e lartë gjatë hapjes së ofertave.

VALËT E SHITJEVE

VALA - 57 - 29 maj 2013

Vala - 58 - 29 maj 2013

Vala - 59 - 09 tetor 2013

31

Ndërmarrje të reja

23

Ndërmarrje të reja

40

Ndërmarrje të reja

79

oferta

54

oferta

85

oferta

€ 9,506,340

shuma totale e ofertave të pranuar

€ 5,188,345

shuma totale e ofertave të pranuar

€ 9,525,674

shuma totale e ofertave të pranuar

Për trembëdhjetë (13) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për tetë (8) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për njëmbëdhjetë (11) Ndërmarrje të Reja të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë.

Për 21 ndërmarrjet për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi/aprovui 10 oferta ndërsa refuzoi (11) oferta. Rrjedhimisht u permbyllen dhjetë (10) kontrata të shitjes.

Pas analizës për Ndërmarrjet e reja për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- Dy (2) Ndërmarrje të Reja ishin jo atraktive
- Një (1) Ndërmarrje e Re kishte kontest rreth investimeve të qiramarresit paraprak
- Një (1) Ndërmarrje e Re ishte larguar nga Vala e Privatizimit paraprakisht dhe
- Shtatë (7) Ndërmarrje të Reja shkaqet ishin të panjohura.

Për gjashtë (6) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për tetë (8) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për nëntë (9) Ndërmarrje të Reja të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë.

Për 14 ndërmarrjet për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi/aprovui 5 oferta ndërsa refuzoi (9) oferta. Rrjedhimisht u permbyllen (4) kontrata të shitjes, për arsye se për një Ndërmarrje të Re është pranuar Masa e parakohshme.

Pas analizës për Ndërmarrjet e reja për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- Një (1) Ndërmarrje e Re ishte jo-atraktive – pozitë e papërshtatshme
- Tri (3) Ndërmarrje të Reja lokacioni i të cilave është në Veri të vendit dhe si rrjedhim është paraqitur mungesë interesimi.
- Një (1) Ndërmarrje e Re aseti i së cilës gjindet në rajon rural dhe si rrjedhim është paraqitur mungesë interesimi dhe
- Katër (4) Ndërmarrje të Reja shkaqet ishin të panjohura

Për trembëdhjetë (13) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për shtatëmbëdhjetë (17) Ndërmarrje të Reja të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për dhjetë (10) Ndërmarrje të Reja të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë.

Për 30 ndërmarrjet për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi/aprovui 26 oferta ndërsa refuzoi 9 oferta. Sa i përket përmbylljes së kontratave të shitjeve, vlen të theksohet se, të gjitha procedurat janë bartur në vitin 2014 për shkak të afateve kohore të përcaktuara në Rregullat e aplikueshme të Tenderit.

Pas analizës për Ndërmarrjet e reja për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- Katër (4) Ndërmarrje të Reja ishin jo-atraktive
- Dy (2) Ndërmarrje të Reja kishin pretendime pronësore dhe për njërën nga to ishte bërë thirrje publike në media nga pretenduesi për mos tenderim dhe
- Katër (4) Ndërmarrje të Reja shkaqet ishin të panjohura.

SHITJA E ASETEVE TË NDËRMARRJEVE

SHITJA PËRMES LIKUIDIMIT

- 19 -

24 prill 2013

30

asete

83

oferta

€ 5,402,469

shuma totale e ofertave
të pranuar

Për gjashtëmbëdhjetë (16) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për dhjetë (10) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për katër (4) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur (3) refuzime të ofertave.

Për njëzet e gjashtë (26) asete për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi/aprovoi njëzet e dy (22) oferta ndërsa refuzoi katër (4) oferta. Rrjedhimisht u permbyllen shtatëmbëdhjetë (17) kontrata të shitjes, për shkak se katër (4) asete kanë dështuar gjatë procesit, gjegjësisht, gjatë pagesave dhe një (1) aset është ende në pritje të nënshkrimit nga ana e blerësit.

Pas analizës për Asetet e propozuara për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- Dy (2) asete ishin jo-atraktivë
- Një (1) aset ishte pavlerë dhe
- Një (1) aset shkaqet ishin të panjohura

SHITJA PËRMES LIKUIDIMIT

- 20 -

03 korrik 2013

74

asete

120

oferta

€ 2,623,291

shuma totale e ofertave
të pranuar

Për njëzet e dy (22) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për njëzet e pesë (25) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për njëzet e shtatë (27) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur (3) refuzime të ofertave.

Për dyzet e shtatë (47) asete për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi/aprovoi tridhjetë e katër (34) oferta ndërsa refuzoi trembëdhjetë (13) oferta. Rrjedhimisht u permbyllen njëzet e gjashtë (26) kontrata të shitjes, për shkak se:

- Për një (1) aset ishte pranuar masa e parakohshme
- Për një (1) aset kishin rezultuar probleme kadastrale (pas aprovimit të Bordit),
- Dy (2) asete kanë dështuar gjatë procesit, gjegjësisht, në pagesa dhe
- Katër (4) asete janë ende në proces.

Pas analizës për Asetet e propozuara për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- Për tri (3) asete interesimi ishte i vogël
- Për një (1) aset nuk kishte interesim fare
- Për njëmbëdhjetë (11) asete kishte pasur edhe asete tjera afër Tri (3) asete ishin të uzurpuara nga palët tjera
- Tetë (8) asete ishin jo-atraktivë dhe
- Një (1) ishte i rrethuar me pronë private

SHITJA PËRMES LIKUIDIMIT

- 21 -

10 shtator 2013

47

asete

94

oferta

€ 4,532,927

shuma totale e ofertave
të pranuar

Për shtatëmbëdhjetë (17) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për trembëdhjetë (13) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për shtatëmbëdhjetë (17) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur 2 refuzime të ofertave.

Për tridhjetë (30) asete për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi/aprovoi njëzet e një (21) ndërsa refuzoi nëntë (9) oferta. Rrjedhimisht u permbyllen pesëmbëdhjetë (15) kontrata të shitjes, për shkak se:

- Tri (3) asete janë ende në proces dhe
- Tri (3) asete kanë dështuar gjatë procesit, gjegjësisht, në pagesa.

Pas analizës për Asetet e propozuara për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- Dy (2) asete gjenden në veri të vendit
- Një (1) aset lokacioni nuk është atraktiv për investitor
- Një (1) aset kishte pësuar ndryshime kadastrale nga NSH në person privat në bazë të vendimit të Zyrës për Kadastër dhe Gjeodezi – KK Gjakovë.
- Trembëdhjetë (13) asete shkaqet ishin të panjohura.

SHOQËRORORE NË LIKUIDIM

SHITJA PËRMES LIKUIDIMIT

- 22 -

18 nëntor 2013

44

asete

82

oferta

€ 4,279,524

shuma totale e ofertave
fituese

Për dymbëdhjetë (12) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për tetëmbëdhjetë (18) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për katërbëdhjetë (14) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur 2 refuzime të ofertave.

Për tridhjetë (30) asete për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi/aprovui njëzet e një (21) ndersa refuzoi nëntë (9) oferta. Sa i përket përmbylljes së kontratave të shitjes, vlen të theksohet se, të gjitha procedurat janë bartur në vitin 2014 për shkak të afateve kohore të përcaktuara në Rregullat e aplikueshme të Tenderit.

Pas analizës për Asetet e propozuara për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- Tetë (8) asete ishin jo-atraktive
- Katër (4) asete ishin me pretendime pornësore
- Një (1) aset ishte larguar për shkak të Vendimit të Gjykatës
- Një (1) aset ishte i uzurpuar

SHITJA PËRMES LIKUIDIMIT

- 23 -

11 dhjetor 2013

73

asete

176

oferta

€ 6,652,234


shuma totale e ofertave
fituese

Për njëzet e tetë (28) njësi të tenderuara u pranuan tri (3) apo më shumë oferta, për njëzet e dy (22) njësi të tenderuara u pranuan më pak se tri (3) oferta dhe për njëzet e pesë (25) njësi të tenderuara nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur tetë (8) refuzime të ofertave.

Për dyzet e tetë (48) asete për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi/aprovui njëzet e tri (23) ndersa refuzoi njëzet e pesë (25) oferta. Sa i përket përmbylljes së kontratave të shitjes, vlen të theksohet se, të gjitha procedurat janë bartur në vitin 2014 për shkak të afateve kohore të përcaktuara në Rregullat e aplikueshme të Tenderit.

Pas analizës për Asetet e propozuara për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- Pesë (5) asete asete ishin jo-atraktive
- Pesëmbëdhjetë (15) asete kishin vendimin e KK Rahovec për kthimin e pronave
- Një (1) aset është tërhequr nga Autoriteti i Likuidimit
- Një (1) aset me ndërtim të përkohshëm në tokën që udhëhiqet në emër të KK Mitrovicë
- Tri (3) asete me lokacion atraktiv, por që mund të jetë edhe si pasojë e shfrytëzuesit



NËNSHKRIMI I KONTRATAVE ME BLERËSIT

- Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2013 janë nënshkruar dhe dorëzuar tek blerësit gjithsej 136 Kontrata (Likuidim 105, Spin-Off 31).
- Edhe një numër i konsiderueshëm i kontratave janë në proces.

ARSYET E KONTRATAVE TË PAPËRFUNDUARA

SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

Për tetë (8) shitje kemi ndalesa nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Si rrjedhim, masat e përkohshme ka raste kur janë marrur para miratimit të shitjeve nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Poashtu, ka raste kur masat e përkohshme kanë ardhur pas përfundimit të gjitha pagesave dhe procedurave të parapara me Rregulla të aplikueshme të Tenderit. Andaj, të gjitha kontratat e Ndërmarrjeve të Reja/Aseteve të poshtëshënuara, mbesin pezull deri në vendimin final të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Ndalesat vlejné për ndërmarrjet në vijim:

- Ndërmarrja e Re Farmakos Blue Factory SHPK - Vala - 2, Masa e Përkohshme është hequr në Janar të vitit 2014 dhe pritët që ky aset të privatizohet së shpejti.
- Ndërmarrja e Re Agrokosova – Zyret SHPK Vala - 37, Masa e Përkohshme është vendosur me datë 27 tetor 2009, pas mbledhjes së Bordit të Drejtorëve e cila është mbajtur me 30 Shtator 2009.
- Ndërmarrja e Re KB Shtime – Zyra Administrative SHPK – Vala 37, Masa e Përkohshme, është vendosur me datë 05 maj 2010, pas mbledhjes së Bordit të Drejtorëve Drejtorëve e cila është mbajtur me 30 Shtator 2009 dhe pasi që kanë përfunduar të gjitha procedurat sipas Rregullave të aplikueshme të Tenderit.
- Ndërmarrja e Re Punetoria Iliria SHPK – Vala 43, Mase e Përkohshme është vendosur me datë 07 shtator 2010, pas mbajtjes së mbledhjes së Bordit të Drejtorëve e cila është mbajtur me 28 Maj 2010 dhe pasi që kanë përfunduar të gjitha procedurat sipas Rregullave të aplikueshme të Tenderit.
- Ndërmarrja e Re Jugobanka Zyra ne Sken-

deraj - Vala 59, Masa e Përkohshme është vendosur me datë 03 tetor 2013, para mbledhjes së Bordit të Drejtorëve e cila është mbajtur me datë 31 Tetor 2013.

- Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Babaj i Bokës - Vala 59, Masa e Përkohshme është vendosur me datë 03 Dhjetor 2013 – Pas mbledhjes së Bordit të Drejtorëve e cila është mbajtur me datë 31 Tetor 2013 dhe pasi që kanë përfunduar të gjitha procedurat sipas Rregullave të aplikueshme të Tenderit.
- Ndërmarrja e Re Ereniku Industria Depo ne Zonën Industriale Prishtinë –Vala 59, Masa e Përkohshme është vendosur me datë 10 tetor 2013, para mbledhjes së Bordit të Drejtorëve e cila është mbajtur me datë 31 Tetor 2013.
- Njësia nr. 12: Lavërtari Blegtori – Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme I – SHAL 20 – Masa e Përkohshme është vendosur me datë 02 Tetor 2013 pas mbledhjes së Bordit të Drejtorëve e cila është mbajtur me datë 18 Korrik 2013 dhe pasi që kanë përfunduar të gjitha procedurat sipas Rregullave të aplikueshme të Tenderit.

SHITJET ME PROBLEME TJERA

Një shitje është me probleme dhe kontrata nuk është kryer akoma:

- Ndërmarrja e Re “Koopërimi Toka Bujqësore Treboviq Sh.P.K.”-Vala 42 – prona ka mbetur në emër të Institutit Bioteknik në Pejë, për shkak të mos azhurnimeve në komunën e Pejës.

*Blerësit iu kanë kthyer mjetet deri në vendimin e ardhshëm të Gjykatës.

ADMINISTRIMI DIREKT

Në rrjedhën normale të ngjarjeve, mbikëqyrja, kontrola dhe monitorimi i ndërmarrjeve është bërë nga Zyrat Rajonale të AKP-së. Masat e Administrimit Direkt janë implementuar në rastet specifike kur një NSH kishte ngadalësim apo ngecje në progres apo ishte në rrezikshmëri financiare për shkak të keqmenaxhimit, apo dëmtimit të aseteve e që reflektonte në dëm të interesave të NSH-së dhe punëtorëve të saj. Kur Zyrat Rajonale të kenë shterur të gjitha mundësitë dhe opsionet për të gjeneruar ndikim pozitiv në NSH-në e cila shfaq një trend të rënies, atëherë propozohen masat e Adminis-

trimit Direkt nga Zyrat Rajonale të AKP-së për t'u implementuar në këtë ndërmarrje. Të gjitha NSH-të e vendosura dhe/ose të larguara nga AD janë të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

1. NDËRMARRJET TË CILAT AKTUALISHT JANË NËN ADMINISTRIM DIREKT :

Ndërmarrja e Re "Grand Hotel Prishtina" Prishtinë
NSH "Ereniku-Industria" Gjakovë
NSH "Boksitet e Kosovës" Klinë
NSH "Fapol" Podujevë

Ndërmarrja e re "Grand Hotel Prishtina" Prishtinë

Ndërmarrja e re Grand Hotel është vendosur nën Administrim Direkt më 20 Korrik 2012. Gjendja e kësaj Ndërmarrje ka qenë shumë e vështirë. Në pjesën e dytë të vitit 2012 si dhe gjatë viti 2013 AD ka arritur këto rezultate:

- Administrimi Direkt, ka arritur të aktivizoj qasjen në ujësjellës, linja telefonike dhe në internet (wireless)
- Ka arritur të nënshkruaj marrëveshje për riprogramim të borxheve me Ndërmarrje publike, KEK, PTK, TERMOKOS.
- Ka arritur që të shpërndajë pagat e punëtorëve të cilët nuk kishin marrë 8 pagat e fundit nga ana e ish-blerësit të kësaj Ndërmarrje.
- Ka arritur lëshimin me qira të disa aseteve (parkingu, zyre, lokale afariste, restorante dhe hapësira reklamuese) nga të cilat janë paguar borxhet e Ndërmarrjes si dhe janë siguruar pagat për punëtorë. AKP në vazhdimësi po bën përpjekje për të kthyer imazhin e hotelit përmes njoftimeve për publikun, promovimeve të çmimeve të reja dhe mënyrave tjera të marketingut.
- Janë bërë renovime të sistemit të brendshëm të ngrohjes, sistemit elektrik, si dhe renovimi i disa pjesëve/hapësirave të dëmtuara nga ish Blerësi.

Si rrjedhojë e kësaj Ndërmarrje ka një trend të ngritjes së vazhdueshme të të hyrave dhe zvogëlimit të shpenzi-

meve. Aktualisht nga qiradhënia e aseteve ka krijuar të hyra mujore në vlerë prej 33,097.50 € (tridhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë cent).

Ndërmarrja Shoqërore "Ereniku-Industria" Gjakovë

Gjatë vitit 2013 të AD se bashku me Ndërmarrjen ka arritur kthimin në posedim të Ndërmarrjes disa asete të cilat ishin shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme nga uzurpues të ndryshëm.

Me datën 12 prill 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar nga Ministria e Bujqësisë raportin e punës lidhur me cilësinë e verës e cila gjendet në Bodrumin e verës pronë e NSH "Ereniku-Industria" Gjakovë. Nga raporti del se, vera e cila gjendet të NSH "Ereniku-Industria" nuk i përgjigjet kushteve dhe kualitetit sipas ligjit për verëra Nr. 02/L-8. Ky konstatim është i bazuar në analizat fiziko-kimike të verës që janë bërë në IBK-Pejë, nga e cila rezulton se të gjitha mostrat janë me të meta. Njëkohësisht në këtë raport punë, MBPZHR kanë hedhur poshtë ankesën e AKP-së si të pabazuar.

Në këtë kontekst, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka kërkuar nga Ministria e Bujqësisë si institucioni i specializuar dhe i autorizuar për tu marre me këtë çështje duke kërkuar nga Ministria që të na rekomandojë se si të veprohet me verën në fjalë, a mund të futet në qarkullim si lëndë e parë për përpunim dhe prodhim të ndonjë produkti tjetër dhe nëse po si dhe në çfarë cilësie mund të përdoret.

Ministria e Bujqësisë pas kërkesës së AKP-së për të dhënë një rekomandim-propozim profesional që vera të mos dëmtohet tërësisht dhe si lëndë e parë për përpunim të përdorët për përfitimin e ndonjë produkti tjetër, MBPZHR nëpërmjet DPMB, Entit VV ka zhvilluar konsultë të vazhdueshme me teknolog dhe enolog me përvojë në këtë fushë dhe ka ardhur deri te ky përfundim:

1. Vera e deponuar në NSH "Industria-Ereniku" një pjesë mund të përdoret për përfitimin e destilatit në përmbajtje 65-70%.
2. Pjesa tjetër e lëndës së parë (vërës) mund të nënshtrohet përpunimit dhe kalimit në uthulle.

Këto propozime vijnë si rezultat i raportit të analizave fiziko-kimike të IBK-së dhe se kjo verë (44 mostra) nuk i përgjigjet kushteve të kualitetit sipas Ligjit për Verërat Nr. 02/L-8, Neni 38 pika b dhe c.

Lidhur me të lartcekurat dhe pas analizimit të situatës së krijuar, pas kërkesës emergjente të Bordit të Ndërmarrjes për domosdoshmërinë e shitjes së verës, pasi

qe qëndrimi i mëtutjeshëm i saj ne kushte dhe rrethana çfarë janë krijuar, seriozisht e dëmton cilësinë e verës. Lidhur me këtë në pajtim me dispozitat juridike nga neni 4.2 pika (iv) Menaxhmenti i AKP-së i ka propozuar Bordit të Agjencisë që të merr vendim lidhur me aprovimin e propozimit që “NSH Ereniku-Industria” të mund të publikojë tenderin e shitjes së produktit të destilatit të verës i cili gjendet në Bodrumin e verës të NSH “Ereniku-Industria” Gjakovë, dhe të procedohet shitja duke respektuar rregullat për tenderim publik.

Pas publikimit të shpalljes për shitjen e produktit (destilatit) të verës, dhe ofertave të pranuar, është proceduar tutje me aprovimin e ofertës me të larte ne vlere prej 218.156.60. Nga mjetet e akumuluar janë paguar borxhet ndaj punetoreve në emër të pagave të papaguara dhe është iniciuar pagesa e borxhit tatimor ndaj ATK-së.

Gjate vitit 2014 presim që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të vendosë lidhur me masën e përkohshme e cila ka pezulluar shitjen e aseteve të kësaj Ndërmarrje.

Ndërmarrja Shoqërore “Boksitet e Kosoves” Klinë

Ndërmarrja ka hyrë në AD në fillim të vitit 2012 (20 janar 2012); ka pasur probleme të mëdha rreth arkëtimit të borxheve nga qiratë e aseteve; obligime ndaj ATK, KEK dhe paga të papaguara të punëtorëve etj. Në vitin 2013 Ndërmarrja është përballur me vështirësi kryesisht në aspektin operacional, ngase si Ndërmarrje Shoqërore nuk po mund të jete konkurrencte në treg, me ato pak kapacitete që i posedon. Të vetmet të hyra të realizuara nga Ndërmarrja ishin nga qiradhënia e Separacionit, dhe Fabrikës së Llaçit të thatë. Edhe këto dy qira janë realizuar me vështirësi.

Gjatë periudhës nën AD, pas konstituimit të Bordit të përkohshëm Menaxhues, në bashkëpunim me zyrtaret e Administrimit Direkt të AKP-së, ndërmarrja edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar trendin e rritjes së hyrave kryesisht nga arkëtimi i borxheve nga qiraxhinjtë kryesor. Gjate vitit 2013 Menaxhmenti i ndërmarrjes ka bërë kërkesë për lëshimin e serishëm me qira të Fabrikës së Llaçit të thatë, ngase kontrata e vitit 2012 kishte skaduar. Janë përzgjedhur operatorët ekonomik të cilët kishin ofertuar çmimin me të larte për qira mujore. Ndërsa me Qiramarrësin e Separacionit ishte vazhduar kontrata e qirasë. Me të njëjtit ishte nënshkruar kontratë një vjeçare. Gjate zbatimit të këtyre kontratave ndërmarrja dhe AKP-ja kanë hasur në veshiresi të konsiderueshme sa i përket realizimit të kontratave të qirasë, kjo për shkak të vështirësive të zhvillimit të afarizmit nga ana e Qiramarrësve. Në fund të vitit kontratat me të njëjtit ope-

rator nuk janë vazhduar.

Gjate vitit 2014 do të lëshohen me qira Separacioni dhe Fabrika e Llaçit si dhe parkingu i Ndermarrjes. Nga lëshimi i këtyre aseteve do të ngriten të hyrat dhe të rregullohet mirëqenia e punetoreve.

2. NDËRMARRJET E VËNA NËN ADMINISTRIM DIREKT GJATË PERIUDHËS JANAR – DHJETOR 2013:

NSH “Fapol” Podujevë

Kjo Ndërmarrje ishte komercializuar në vitin 2001. Pas skadimit të afatit të kontratës së komercializimit NSH “Fapol” më 30 Qershor 2012, është kthyer nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, respektivisht Zyrës Regjionale të Prishtinës me qëllim që ndërmarrja të përgatitet për privatizim.

Me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së kjo Ndërmarrja me datë 06 Qershor 2013 është vendosur nën Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së me qëllim të krijimit të një strukture të brendshme organizative, dhe me qëllim të hartimit të skemës së pagave konform kërkesës për rritjen e tyre. Kjo Ndërmarrje menaxhohet nga Bordi i Përkohshëm Menaxhues i emëruar nga Bordi i AKP-së, dhe operon me gjithsejtë 92 punëtorë duke përfshirë edhe 6 punëtorë në asistencë financiare të cilët angazhohen herë pas here duke zëvendësuar ndonjërin nga punëtorët aktiv.

Pas futjes së Ndërmarrjes Shoqërore nën kontrollin të Njësisë së Administrimit Direkt, duke u mbështetur në ligjin e AKP-së dhe politikat operationale, me qëllim të rritjes së vlerës dhe menaxhimit më të mirë të ndërmarrjes, u ndërmorën masat e menjëhershme si në vijim:

- Inspektimi i hapësirës së Ndërmarrjes.
- Inspektimi i aktiviteteve financiare dhe qasja në xhirologaritë bankare të Ndërmarrjes.
- Inspektimi i dokumenteve ligjore, përfshirë aktivitete të kontraktuara.
- Regjistrimi i aseteve të Ndërmarrjes.
- Takimi me Menaxhmentin, Sindikatën e Punëtorëve dhe njoftimi me Ligjin dhe rregulloret e punës së AKP-së.

Duke konstatuar këtë gjendje në Ndërmarrje, pakënaqësinë e punëtorëve për shkak të pagave të ulëta dhe kërkesave të vazhdueshme të tyre për rritje të pagave, me arsyetimin se Ndërmarrja posedon mjete të mjaftueshme financiare, Njësia e AD ka ndërmarr hapat e men-

jëhershëm për të hartuar rregulloren e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës në Ndërmarrje, e cila është konsideruar si e domosdoshme për mbarëvajtjen më të mirë të punës, rritjen e pagave, e që njëkohësisht do të ndikoj në rritjen e vlerës së Ndërmarrjes Shoqërore. Si rrjedhojë me vendim të Bordit të drejtorëve të AKP-së me datën 18 Korrik 2013 është bërë rritja e pagave në vlerë prej 28.32%.

Ndërmarrja është duke u ballafaquar me vështirësi të konsiderueshme kryesisht në aspektin e dokumentacionit pronësor. Komuna e Podujevës përmes vendimit të Asamblesë Komunale ka nxjerrë vendim për ndryshimin e emërimit të pronës së Ndërmarrjes duke e kthyer atë nga prona Shoqërore në prone Komunale. Edhe përkundër reagimeve të shumta të AKP-se, dhe kërkesës për kthimin e pronës në gjendje të mëparshme Komuna e Podujevës ka qenë e mbyllur duke mos komunikuar zyrtarisht me AKP. Lidhur me problematiken në fjalë, AKP-ja i është adresuar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si institucion kompetent për të shqyrtuar vendimet e Komunave. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka dërguar shkrese-kërkesë në Komunën e Podujevës duke kërkuar që urgjentisht të shfuqizohet vendimi për ndryshimin e titullarit të pronës, dhe prona të kthehet në emër të Ndërmarrjes. Edhe përkundër kësaj kërkesë Komuna ende nuk ka ndërmarr asnjë veprim. Situata e krijuar është duke vështirësuar tej mase funksionimin e Ndërmarrjes por edhe ushtrimin e mandatit të AKP-së. Si rrjedhojë Terminali Doganor nuk mund të aplikoj për licencë pasi që nuk posedon Certifikatën pronësore në emër të Ndërmarrjes. Kjo ka ndikuar në rënien e të hyrave të Ndërmarrjes, ngase shpedicionet kanë filluar të largohen dhe të vendosen në Terminalin Doganor privat, por edhe Dogana e Kosovës ka paralajmëruar se nëse Ndërmarrja nuk pajiset me licencë ata do të detyrohen të largohen nga ky terminal.

Aktualisht Ndërmarrja nuk ka detyrime të papaguara. Gjendja e llogarisë bankare deri më 31.12.2013 është rreth 800,000€.

Gjate vitit 2014 do të tentohet të evitohen problemet ligjore dhe të privatizohet Ndërmarrja në tërësi, Terminalit Doganor, dhe Fabrika e Gypave të polisterit e cila është jashtë funksionit.

3. NDËRMARRJET QË JANË LARGUAR NGA ADMINISTRIMI DIREKT GJATË VITIT 2013

NSH "Artizanati – Kosovarja" Prishtinë

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, duke u bazuar në dispozitat juridike nga nenit 6 të rregullores Nr. 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit me datë: 20/06/2006, ka marrë vendim për futjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen Shoqërore "Artizanati Kosovarja", Prishtinë duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë.

Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë të AKP-së është ballafaquar me probleme të shumta në këtë Ndërmarrje e sidomos në aspektin financiar dhe ligjor.

Që nga viti 2006 ka vazhduar realizimi i pagave mujore duke përfshirë edhe pagesat e kontributit pensional dhe tatimit të mbajtur në burim të 13 (trembëdhjetë) punëtorëve të Ndërmarrjes nga marrëveshja e qerasë që kjo ndërmarrje ka me Ministrinë e Punëve të Brendshme në shumë prej 3,000.00 euro për muaj, plus TVSH-ja;

Menaxhmenti i AKP-së, ka konsideruar se shkakët të cilat e kanë sjellë gjendjen e vështirë në Ndërmarrjen "Artizanati Kosovarja" në Prishtinë, përkatësisht futjen e Ndërmarrjes nën mbikëqyrjen e Njesisë së Administrimit të Drejtpërdrejtë, tanimë janë evituar, dhe si rezultat i kësaj nuk ekziston asnjë arsye që kjo ndërmarrje të qëndrojë nën mbikëqyrjen e kësaj Njësie brenda Shitjes të AKP-së.

Me propozimin e Menaxhmentin të AKP-së kjo Ndërmarrja Shoqërore "Artizanati Kosovarja", Prishtinë është larguar nga mbikëqyrja e Njesisë së Administrimit të Drejtpërdrejtë të AKP-së, dhe është vendosur nën administrimin e Zyrës Regjionale të Prishtinës e cila do të vazhdojë me shitjen e aseteve të mbetura të kësaj Ndërmarrje.

Ndërmarrja e re Miniera "XIM Strezovc" Kamenicë

AKP me datë: 20/07/2012 ka marrë vendim për futjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen e Re "Miniera Xim-Strezovc" duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë.

Menaxhmenti i AKP-së, Njësia e Administrimit Direkt ka ekzekutuar vendimin e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vendosjen e Kontrollit të Drejtpërdrejt

mbi Ndërmarrjen.

Pas takimeve të shumta, konsultimeve, dhe bashkëpunimit me Udhëheqësit e Ndërmarrjes, Sindikatën e Pavarur të Ndërmarrjes së re, dhe pas analizimit të dokumenteve relevante, dhe historikut të punëtorëve të kësaj Ndërmarrjeje, në pajtim me nenin 6 pika 1.1, 1.2 të ligjit të AKP-së, Menaxhmenti i AKP-së, ka propozuar listën me anëtarë të Bordit e cila është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datën

Veprimet e ndërmarra nga AD pas vendosjes së Ndërmarrjes nën Administrim Direkt:

- Emërimi i Menaxhmentit të Ri;
- Regjistrimi i aseteve;
- Debllokimi i llogaris bankare;
- Qasje në llogarinë bankare prej dy Zyrtareve (Zyrtarit të Ndërmarrjes dhe Zyrtarit të AKP-së);
- Përpilimin e procedurave për mbajtjen e arkës;
- Përpilimin e procedurave të furnizimit;
- Shitja e mbeturinave metalike (skrapit) me ç'rast janë rritur të hyrat dhe është paguar Bordi i ndërmarrjes.

Pasi që me Administrimin e Drejtpërdrejt është arritur stabiliteti i Ndërmarrjes në aspektin e menaxhimit, ruajtjes së aseteve dhe rritjes së vlerës së Ndërmarrjes, si dhe duke u nisur nga fakti që në mungesë të aseteve të cilat ishin dëmtuar dhe asgjësuar nga ish Blerësi, si dhe në mungesë të resurseve humane dhe financiare, kjo Ndërmarrje nuk ka qenë në gjendje të riorganizohet dhe të fillojë aktivitetin e saj primar e as ndonjë aktivitet tjetër operacional nga i cili do të gjeneroheshin të hyra, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje të krijuar arsyeshmeria e vazhdimit të implementimit të masave të Administrimit Direkt kane pushur.

Pas tërheqjes së kësaj Ndërmarrjeje nga AD, Agjencia Kosovare e Privatizimit bazuar në ligjin 04/L-034 neni 8 pika 5 ka futur këtë Ndërmarrje në Likuidim.

NSH "Lavërtaria dhe Blegtoria" Prizren

Me vendim të Bordit të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit të datës 20.07.2006, NSH KBI "Progres" Lavërtaria- Blegtoria"-Drejtoria, Prizren, është futur nën Administrim Direkt duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë. Aktiviteti primar i Ndërmarrjes është: kultivimi i rendimenteve Bujqësore dhe Blegtorale.

Ndërmarrja ballafaqohet me një problem të vazhdueshëm që e përcjell atë një kohë të gjatë, obligimet e larta ndaj ATK në vlerë prej 320.812,84 (treqind e njëzet mijë e tetëqind e dymbëdhjetë euro e tetëdhjetë e katërcent). Në pamundësi të shlyerjes së këtyre obligimeve NSH po ballafaqohet me masat e ndërmarra nga ATK që ka rezultuar me bllokim të llogarisë bankare. Që nga ajo kohë, gjendja financiare është vështirësuar dukshëm, duke pezulluar çdo aktivitet të NSH që nga ajo periudhë. Si pasojë e bllokimit, ndërmarrja nuk e ka ushtruar veprimtarinë e saj, mbjelljen e një sipërfaqeje të tokave të punueshme që posedon, nga e cila veprimtari kishte arkëtuar edhe mjete për pagesën e pagave për punëtorët. Aktualisht aktiviteti kryesor i ndërmarrjes është ruajtja e aseteve si dhe ndihma e AKP-së me dokumentacione relevante që shërbejnë për privatizim, si dhe përfaqësimi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme së bashku me zyrtarin ligjor të AKP-së, lidhur me kontestet pronësore të lartpërmendura.

Gjatë periudhës nën masat e Administrimit Direkt janë shitur disa asete të vlefshme të kësaj NSH:

- Ferma e lopëve në Arbanë
- Toka bujqësore në Lubizhdë,
- Administrata e vjetër "Hotel Tirana"
- Ferma "Barutana"

Kjo ndërmarrje posedon toka bujqësore si dhe disa objekte përcjellëse të cilat janë potencial për privatizim.

Pasi që ndërmarrja nuk ushtron aktivitetin e saj primar e që është: Kultivimi i rendimenteve Bujqësore dhe Blegtorale, dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka aktivitete financiare e as operationale të cilat do të monitoroheshin dhe kontrolloheshin nga AD, është krejtësisht e panevojshme që mbi këtë ndërmarrje të vazhdohej të ushtrohen masat e kontrollit të drejtpërdrejt.

NSH "Vreshtaria" Prizren

Agjencia Kosovare e Privatizimit (e Mirëbesimit në atë kohë), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, me datë: 21/07/2004, ka marrë vendim për futjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen Shoqërore "Vreshtaria" Prizren duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë.

Njëësia e Administrimit Direkt ka bërë përpjekje që Ndërmarrja të jete aktive dhe të shfrytëzohen pronat e kësaj Ndërmarrjeje për kultivimin e rrushit, mirëpo për shkak të mungesës së resurseve njerëzore si dhe pa-

mundësisë së funksionalizimit të vneshtave, aktivizimi ishte i pamundur.

Në pamundësi që Ndërmarrja të filloj vete aktivitetin e saj prodhues, disa asete të kësaj Ndërmarrje ishin dhënë me qira në periudha të caktuara kohore.

Pasi që Ndërmarrja nuk ka zhvilluar ndonjë aktivitet ekonomik/financiar, dhe roli i Administrimit Direkt në këtë NSH ka qenë shumë i vogël, asetet e mbetura të kësaj NSH-je do të përgatiten për privatizim nga Zyra Rajonale e Prizrenit, andaj lidhur me këtë, Menaxhmenti i AKP-së ka konsideruar se nuk ekziston ndonjë arsye ligjore e as operacionale që kjo ndërmarrje të qëndroj nën Administrim të drejtpërdrejt të AKP-së. Prandaj me vendim të Bordit të AKP-së NSH "Vreshtaria" është tërhequr nga Njësia e Administrimit Direkt.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me datë: 21/09/2006, ka marrë vendim për futjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen Shoqërore "Unimont", Prizren duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë.

Një Ndërmarrje e re (Administrata/Objekti i Drejtorisë) është privatizuar dhe është përmbyllur ratifikimi i kontratave me blerësit.

Aktualisht ndërmarrja nuk gjeneron të hyra të mjaftueshme as për mbulimin e pagave, ngase nuk e ushtron aktivitetin e saj primar. Prona e mbetur e sajë edhe pse kontestuese me Komunën e Prizrenit ndodhet në Hipotekë.

Industria në Krushë të Vogël ka qenë e tenderuar në valën e 52 të privatizimit, por për shkak të kontestit me KK Prizren këto dy asete të ndërmarrjes janë tërhequr prej kësaj vale të privatizimit.

Pasi që Ndërmarrja nuk zhvillon aktivitetin e sajë primar e as ndonjë aktivitet ekonomik/financiar, ndërsa roli i Administrimit Direkt në këtë NSH është shumë i vogël, si dhe duke konsideruar se objekti i drejtorisë është privatizuar dhe pengesave që na paraqiten për shitjen edhe të dy aseteve tjera të Ndërmarrjes, Menaxhmenti i AKP-së ka konsideruar se nuk ekziston ndonjë arsye operacionale që kjo ndërmarrje të qëndroj nën Administrim të drejtpërdrejt të AKP-së, respektivisht kanë pushuar së ekzistuari arsyet për kontrollin e drejtpërdrejt të Ndërmarrjes. Asetet e Ndërmarrjes do të vazhdojnë të sigurohen nga Kompania e kontraktuar e AKP-së për sigurimin e aseteve. Prandaj si rrjedhojë e kësaj me datën 12 prill 2013 me vendim të Bordit të AKP-së kjo Ndërmarrje është larguar nga Administrimi i Drejtpërdrejtë.

NSH "Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve" Prishtinë

Kjo ndërmarrje është vendosur nën Administrim të Drejtpërdrejt të AKM-së me datën 24 maj 2006. Prej vitit 2006 kjo Ndërmarrje vazhdon aktivitetin e saj nën mbikëqyrjen e Administrimit Direkt të AKM/AKP-së.

Nder masat e para që janë marre në këtë Ndërmarrje është edhe emërimi i Bordit të Përkohshëm Menaxhues. Si kryesues i Bordit në atë kohe ka qenë Z. Bajram Uka, ku në Gusht vitit 2007 është emëruar si U.D Drejtorit Menaxhues të Ndërmarrjes. Është krijuar qasja kolektive në llogarinë bankare ku një zyrtar i AD-së ka pasur qasje të vazhdueshme në transaksionet e Ndërmarrjes. Ndërmarrja është futur në masat e AD të AKM/AKP në një gjendje relativisht të vështirë financiare dhe me obligime të shumta. Që nga viti 2009 e deri me tani ka pasur përmirësim të konsiderueshëm në të gjitha aspektet. Është rritur cilësia në ofrimin e shërbimeve në sport, kulturë, ndaj qiramarrësve, organizatave të panairëve, ngritja e mirëqenies së punëtorëve dhe në shumë segmente tjera më të vogla. Në Shkurt të vitit 2009 me Vendimin e Bordit të Përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes dhe aprovimin e Njësies së AD është bërë ngritja e qirave për 20%, rritje e cila e ka përmirësuar dukshëm gjendjen financiare të Ndërmarrjes.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë investime në vlera të mëdha si Investimet në izolimin e Pllatos, investime në rregullimin e tri sallave të treningjeve, rregullimi i kulmit në sallën e vogël, investime në sallën e kuqe, investimi në shtande (elemente për panair), rregullimi i tavaneve (në korridoret e sallave të treningjeve, në qendrën tregtare, medicina sportive etj), rregullimin e autoparkut mbrapa objektit të Pallatit të Rinisë, investime në mbushjen dhe mirëmbajtjen e bocave kundër zjarrit, investime në qendrën monitoruese-bazën e lajmëruesve të zjarrit, rregullimi i nyjeve sanitare në qendrën tregtare, sallën e kuqe dhe Atilë, rregullimi i zhveshtoreve (gardërobave) për sportistë dhe tualeteve të salla e vogël.

Ndërmarrja sponzoroi pjesërisht aktivitetet e Odës Ekonomike, Simpoziume të ndryshme të institucioneve të ndryshme publike, Filarmonisë së Kosovës, Orkestrës Kamertale të Kosovës, Departamentit për Kulturë dhe Rini të Komunës së Prishtinës, ceremoni të ndryshme të shkollave fillore të Prishtinës, aktivitetet e shkollës për kitarë dhe balet, aktivitetet e Policisë së Kosovës dhe FSK-së, etj.

Njësia e Administrimit Direkt kishte arritur përmirësimin e gjendjes së krijuar apo evitimin e dëmeve eventuale.

ale. Që nga viti 2009 e deri me tani ka pasur dhe vazhdon të ketë përmirësim të konsiderueshëm në të gjitha aspektet duke i mbyllur të gjitha detyrimet dhe duke investuar në përmirësimin e gjendjes infrastrukturore të Ndërmarrjes. Është rritur cilësia në ofrimin e shërbimeve në sport, kulturë, organizim të panairove dhe pangjyrëve, ofrimin e shërbimeve për qiramarrësit, ngjritja e mirëqenies së punëtorëve, si dhe në rregullimin e kushteve infrastrukturore për zhvillimin e aktiviteteve të kësaj NSH-je.

AD kishte hartuar procedura të brendshme për Ndërmarrjen të cilat kishin ndikuar dukshëm në përmirësimin e kontrollit të brendshëm të Ndërmarrjes. Të gjitha furnizimet si dhe kërkesat e Ndërmarrjes për Investime ishin aprovuar nga Administrimi Direkt dhe Menaxhmenti i AKP-së dhe proceduar tutje përmes shpalljeve publike dhe kontrollit gjatë implementimit të tyre.

Ka pasur përmirësim të dukshëm në të hyrat e Ndërmarrjes të cilat gjenerohen kryesisht nga qiraja, aktivitetet kulturore, aktivitetet ekonomike (reklamata), nga parkingu dhe nga mbajtja e panairove dhe pangjyrëve të ndryshme. Përkundër të lartcekurave në disa fusha të caktuara ende ka vend për përmirësime sidomos në aspektin e qeverisjes korporative.

Aktualisht Ndërmarrja ndodhet në një situatë stabile financiare. Mirëpo qëndrueshmëria e ndërmarrjes është vënë në pikëpyetje për shkak të vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme me të cilat Pallati i Rinisë është detyruar që të kompensojë dëmin ndaj disa paditësve të cilët në momentin e shpërthimit të zjarrit në vitin 2000, me kontrata të qerasë ishin shfrytëzues të depove. Të njëjtit kishin ushtruar padi për kompensimin e dëmit, ngase mallrat e tyre ishin dëmtuar gjatë shpërthimit të zjarrit. Këto rrethana e kanë vënë Ndërmarrjen në një situatë të pasigurt për të ardhmen.

Viteve të fundit AKP-ja krahas Administrimit të Ndërmarrjes ishte kryesisht e përqendruar në mbrojtjen ligjore të sajë, ngase qëndrimet e Gjykatës ishin kundërthënëse dhe të pa pranueshme për AKP-në. Aktualisht vendimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme janë të plotfuqishme, ngase ankesat e AKP-së dhe të Ndërmarrjes janë hedhur poshtë si të pa pranueshme. Vlera e dëmit e cila duhet të paguhet nga Ndërmarrja së bashku me kamatat ligjore është diku rreth 3.3 € (tre milion e treqind mijë euro). Në aspektin ligjor shpresa e vetme ka mbetur te prokuroria e shtetit e cila pas kërkesës së Ndërmarrjes ka iniciuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjet juridik i jashtëzakonshëm. Kjo

procedurë për momentin ka pezulluar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës. Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë bazohet në faktin se në procedurë penale rasti është i evidentuar si aksident, dhe askush nuk ishte shpallur fajtor për shpërthimin e zjarrit. Ndërsa në bazë të procedurës civile dëmin e krijuar duhet ta kompensojë vetëm fajtori (shkaktari i dëmit), fakt i cili ende nuk është zbardhur.

Duke konsideruar të lartëcekurat, Njësia e AD, Menaxhmenti i AKP-së kishte konstatuar se arsyet për të cilat kjo NSH është vendosur nën Administrimin e Drejtpërdrejt kanë pushuar së ekzistuari. Obligimet e Ndërmarrjes janë eliminuar, inkasimi i qirasë është në nivelin e kënaqshëm, ruajtja e aseteve po ashtu është në nivel. Mekanizmat e mbikëqyrjes dhe kontrollit janë instaluar në këtë ndërmarrje. Ndërmarrja menaxhohet nga Bordi i përkohshëm Menaxhues i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe afarizmin e shëndosh të Ndërmarrjes. Prandaj është propozuar që kjo NSH të vazhdon të Administrohet nga Zyra Rajonale e Prishtinës. Me vendim të Bordit të Drejtorëve në muajin tetor, kjo Ndërmarrje është larguar nga Administrimi Direkt, dhe është vendosur nën Administrimin e Zyres Rajonale të Prishtinës. Pas largimit të Ndërmarrjes nga AD, aktivitetet e ndërmarrjes kanë vazhduar të monitorohen përmes Zyrarëve të Zyrës Rajonale të Prishtinës. Zyra Rajonale e Prishtinës konform politikave operacionale në vazhdimësi mund të kërkojë nga Ndërmarrja shpalosjen e informatave të cilat kanë të bëjnë me ndonjë veprim të ri ligjor kundër NSH-së. NSH-ja nuk do të ndërmerr ndonjë veprim të ri ligjor pa miratimin e Agjencisë. Ndërmarrja po ashtu do të paraqes raporte raporte mujore për:

- (i) të hyrat dhe shpenzimet (variabile dhe fikse) si dhe rrjedhën e parasë;
- (ii) paratë e gatshme aktuale në dorë dhe bilancet e llogarive bankare;
- (iii) statusin e veprimeve ligjore në proces të inicuar nga NSH-ja dhe
- (iv) transaksionet e rëndësishme komerciale: (d) të gjitha raportet duhet të përfundojnë me pohimin e menaxhmentit të NSH-së se raporti përmbanë të gjitha informacionet e duhura.

NJËSIA PËR KONTROLL DHE MBIKËQYRJE

Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje bazuar në planin e biznesit për 2013 ka përcaktuar prioritetet e veta që kanë qenë si në vijim:

- Mbledhjen dhe analizimin e raporteve financiare të NSH-ve të kryera nga zyrtarët për kontroll dhe mbikëqyrje në rajon dhe koordinimin e aktiviteteve me zyrtarët për objektivat e përbashkëta, vizitat në zyrat rajonale dhe NSH-të me qëllim të verifikimit të informatave lidhur me pronën e këtyre ndërmarrjeve, ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronës, si dhe identifikimin e rasteve ku keq menaxhimi i kësaj prone mund të ndodhë.
- Transferimi i detyrimeve të NSH-ve tek blerësit që i përkasin 12 muajve të fundit ose 3 muajve të fundit në varësi nga lloji i obligimeve që transferohen.
- Vizitat dhe kontaktet me institucionet tjera relevante në mënyrë që të kemi një komunikim më të mirë institucionet e interesit të përbashkët si dhe koordinimin e aktiviteteve me njësitë përkatëse përbrenda njësisë së Qeverisjes së Korporatave dhe departamenteve tjera brenda AKP.

Më poshtë është pasqyruar në mënyrë tabelore përshkrimi i aktiviteteve të arritura të njësisë për kontroll dhe mbikëqyrje për periudhën raportuese 1 Janar deri 31 Dhjetor 2013:

Tabela e aktiviteteve kryesore

AKTIVITETET	TË ARRITURAT GJATE PERIUDHËS RAPORTUESE
RAPORTET FINANCIARE TË PRANUARA NGA NSH-TË	79
TRANSFERIMI I DETYRIMEVE TË NSH-VE TEK	21

Tabela e aktiviteteve tjera

AKTIVITETET	TË ARRITURAT GJATE PERIUDHËS RAPORTUESE
TAKIME ME INSTITUCIONET TJERA	6
NJOFTIMET MBI DETYRIMET E DORËZUARA TEK INSTITUCIONET E TJERA	27
TAKIME ME MENAXHMENTIN E NSH - VE	6
TOTAL	39

Njësia për kontroll dhe mbikëqyrje siç u tha edhe me lartë bën edhe monitorimin e ndërmarrjeve të privatizuara me spin off special dhe ndërmarrjeve të privatizuara me kushte .Në vazhdim po paraqesim raportin mbi ndërmarrjet që janë nën monitorim të NJKM.

SPIN OFF-ET SPECIALE

Që nga fillimi i procesit të privatizimit në Kosovë, e deri më tani janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së Spin Off-it Special. Në anën tjetër 6 ndërmarrje të privatizuar me metodën e Spin Off-it Special kanë qenë në monitorim gjatë vitit 2013 prej të cilave dy ndërmarrje për shkak të plotësimit të kushteve të parapara me marrëveshjen e zotimeve janë liruar nga raportimi (Hotel Iliria dhe Minex) kurse gjatë periudhës kohore Janar – 31 Dhjetor 2013, 4 ndërmarrje kanë vazhduar të jenë aktive, respektivisht në proces të përmbushjes së kushteve të Marrëveshjes për Zotime.

Më poshtë janë të listuara NSH-të e privatizuara përmes metodës së Spin Off-it Special të cilat kanë qenë në procesin e monitorimit gjatë periudhës Janar – 30 Shtator 2013:

- Hotel Iliria
- IDGJ Tobacco
- NBI Suhareka (Agrokosova Holding)
- MIM Golesh
- Minex
- Jugoterm

Ndërmarrjet e Reja “Hotel Iliria”, dhe “Minex”

Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka përgatitur Memorandumin për lirim në bazë të nenit 7.1.1 të Kushteve të Marrëveshjes së Zotimit për Ndërmarrjet e Reja “Hotel Iliria”, dhe “Minex”, pasi që Blerësit bazuar në të gjeturat e Auditorit i kanë përmbushur kushtet e Marrëveshjes, lidhur me këtë me datë 21 dhe 22 maj 2013 Bordi i Drejtorëve të AKP-së në Mbledhjen e mbajtur me datë 21 dhe 22 Mars 2013 ka marrë vendim që bazuar në nenin 7.1.1 të liroj nga Kushtet e Marrëveshjes së Zotimit Ndërmarrjet e Reja “Hotel Iliria” dhe “Minex”.

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco”

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco” ShPK, është privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 11-të të shitjes, ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të parapara në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 13 Gusht 2008. Me datë 27 Mars 2012 është aprovuar Marrëveshja për Përtëritje (Novacion) të Marrëveshjes së Zotimeve lidhur me Ndërmarrjen e Re “IDGJ Tobacco” Shpk nga grupi punues i AKP-së. Kjo Marrëveshje është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 Mars 2012, si dhe është nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira në këtë marrëveshje me datë 12 Prill 2012., ku kusht për këtë ndërmarrje gjatë

periudhës dy vjeçare është të realizoj investime prej 4,000,000.00 € dhe të plotësoj numrin e punëtorëve prej 14 punëtor në muajin e parë, 35 punëtor në muajin e dytë, 55 punëtor në muajin e tretë dhe 90 punëtor nga muaji i katërt e deri në përfundim të Marrëveshjes së Novacionit. Periudha e raportimit për këtë ndërmarrje përfundon me 10 Shtator 2014. Deri më tani kjo Ndërmarrje ka dorëzuar shtatë(7) raporte tre mujore si dhe janë bere dymbëdhjetë vizita monitoruese tek kjo ndërmarrje.

Ndërmarrja e Re “Jugoterm International”

është privatizuar përmes Spin Off-it Special në Valën e 15-të të shitjes, ndërsa ratifikimi i Kontratës është bërë me 17 Prill 2012. Zotimin për Investime duhet të e përmbushë brenda periudhës dy vjeçare në vlerën prej 2,760,000.00 €, ndërsa zotimin për punësim 282 punëtor, gjysmën e punëtorëve gjatë gjashtë muajve, ndërsa pjesën tjetër të punëtorëve deri në përfundimin e Zotimit në bazë të Kontratës. Deri më tani në këtë ndërmarrje janë bere 14 vizita monitoruese dhe nga raportet e dorëzuara nga blerësi dhe vizitat e zhvilluara theksojmë se blerësi është duke iu përmbajtur kushteve të marra përsipër me rastin e privatizimit të kësaj ndërmarrje. Blerësi i ri ka dorëzuar gjashtë raporte tremujore ku ka raportuar për investime dhe punësim.

Ndërmarrja e Re “Miniera dhe Industria e Magnezit Golesh”

është privatizuar me 11 Dhjetor 2007 nga Blerësi IMING d.o.o, përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 22-të të shitjes, ndërsa Marrëveshja për Zotime ka përfunduar me datën 11 Dhjetor 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej 16,200,000 euro si dhe të punësoj 178 punëtorë gjatë 6 mujorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrij gjithsej 355 punëtorë.

Në mars të vitit 2012, AKP-ja ka angazhuar kompaninë vlerësuese “Aurelian Capital” L.L.C, që të bëjë vlerësimin e investimeve të kryera në Ndërmarrjen e Re MIM Golesh. Nga të gjeturat e prezantuara në raportin e vlerësimit rezulton se blerësi ka bërë investime në 13,376,223.59€. Në takimin e muajit mars Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka vendosur që të pezulloj ekzekutimin e vendimit të Bordit të datës 16 Dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve, ndërsa në mbledhjen e Bordit të mbajtur me datën 31 maj 2012 afati për përmbushjen e

obligimeve për MIM Golesh zgjatet për dy vite nga data e nënshkrimit të kontratës. Gjate vitit 2013 Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje nuk ka zhvilluar asnjë vizite monitoruese në këtë ndërmarrje. Gjithashtu vlen të theksohet se me vendim të Drejtorit të AKP-së është formuar komisioni i cili do të përcaktoj kushtet për zgjatjen e kontratës për blerësin në përputhje me vendimin e Bordit.

Ndërmarrja e Re “NBI Suhareka/Agrokosova Holding”

është privatizuar me 27 Gusht 2007 nga blerësi “Gruppo Vinicolo Fantinel” dhe “QMI” përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 19-të të shitjes ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të paraparë në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 27 gusht 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej 8,600,000 euro si dhe të punësoj 173 punëtorë gjatë 6 muorit të

parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrij gjithsej 345 punëtorë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese AKP-ja ka angazhuar auditorë të jashtëm për të audituar përmbushjen e kushteve të marrëveshjes së zotimeve nga blerësit e Ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding”. Sipas raportit të auditorit të jashtëm blerësi i ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding” ka përmbushur kushtin për investime kapitale në nivelin 88.87% ndërsa atë për punësim 39%.

Në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të mbajtur me datën 20 korrik 2012 Bordi ka vendosur që vendimi i Bordit i datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve të mbetet në fuqi por të shtyhet ekzekutimi i këtij vendimi për 6 muaj dhe në ndërkohë të angazhohet një kompani që të bëjë vlerësimin e investimeve të bëra në këtë ndërmarrje dhe pastaj të rishikohet vendimi i Bordit për tërheqjen e aksioneve.

NDËSHKIMET FINANCIARE PËR MOSPËRMBUSHJE TE ZOTIMEVE

Për shkak të mospërmbushjes së zotimeve deri me tani janë aplikuar ndëshkimet financiare për disa blerës të cilët nuk i kane përmbushur ato zotimeve.

Me poshtë japim formën tabelare të ndëshkimeve për periudhën kohore 01 Janar 2013 – 31 Dhjetor 2013 si dhe shumën e përgjithshme të ndëshkimeve financiare që janë aplikuar deri në fillim të vitit 2013:

SHUMA TOTALE E NDËSHKIMEVE PËR 5 SOS

NDËRMARRJA E RE	GJATË VITIT 2013	PREJ DATËS SË FILLIMIT DERI MË 31.12.2012
NDËRMARRJA E RE „GRAND HOTEL“		8,822,314.97
NDËRMARRJA E RE „IDJ TOBACCO“		4,573,649.11
NDËRMARRJA E RE „XIM STREZOVIC“		7,298,170.76
NDËRMARRJA E RE „MIM GOLESHI“		8,447,812.27
NDËRMARRJA E RE „AGROKOSOVA HOLDING“	38,284.12	3,569,997.53
Totali	38,284.12	32,711,944.64

NDËRMARRJET E PRIVATIZUARA ME KUSHTE

Gjatë periudhës Janar – 31 Dhjetor 2013, dymbëdhjetë ndërmarrje të privatizuara me kusht kanë qenë në procesin e monitorimit të përmbushjes së kushteve të kontratës – kryesisht vazhdimin të aktivitetit të njëjtë të biznesit kurse njëra nga to „Remont Servisi” është liruar me vendim të Bordit të AKP-së të datës 21 nëntor 2013 për shkak të përmbushjes së kushteve të marra përsipër me Marrëveshjen e Zotimeve.

Tabela përmbledhëse e ndërmarrjeve të privatizuara me kushte

Nr.	EMRI I NDËRMARRJES	STATUSI
1	NDËRMARRJA E RE „SHARRCEM“	NËN MONITORIM
2	NDËRMARRJA E RE „REMONT SERVIS“	ËSHTË LIRUAR
3	NDËRMARRJA E RE „UNION HOTEL“	NËN MONITORIM
4	NDËRMARRJA E RE „LLAMKOS“	NËN MONITORIM
5	NDËRMARRJA E RE „FAMIPA“	NËN MONITORIM
6	NDËRMARRJA E RE „AMORTIZATORËT“	NËN MONITORIM
7	NDËRMARRJA E RE „DUBRAVA DF“	NËN MONITORIM
8	NDËRMARRJA E RE „EMIN DURAKU - EDICO“	NËN MONITORIM
9	NDËRMARRJA E RE „EMIN DURAKU“ - KI	NËN MONITORIM
10	NDËRMARRJA E RE „FABRIKA E BATERIVE INDUSTRIALE TREPÇA“	NËN MONITORIM
11	NDËRMARRJA E RE „HOTEL ONIX BANJA E PEJËS“	NËN MONITORIM
12	NDËRMARRJA E RE „RILINDJA ZONA INDUSTRIALE“ SHPK	NËN MONITORIM

Ndërmarrja e Re “Sharrcem”

është privatizuar me 09. 12. 2010 për shumë 30.1 milion euro, Ndërsa sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e aksioneve blerësi ka marrë përsipër që gjatë 5 viteve në vijim të bëjë investime në vlerë prej 35 milion euro si dhe të vazhdojë të punësoj gjatë 3 vitet e ardhshme të gjithë ish punonjësit e ndërmarrjes (numri i punonjësve 503).

Blerësi i Ndërmarrjes së Re “Sharrcem” gjatë periudhës 2 vjeçare ka raportuar një shume të konsiderueshme të investimeve kapitale mbi 17 milion euro ndërsa vazhdon të punësoj të njëjtin numër të punonjësve (503 punonjës). Gjatë vitit 2013 Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Bazuar në raportet financiare të pranuar nga NJKM si dhe bazuar në vizitat monitoruese të realizuara gjatë kësaj periudhe mund të theksojmë se Ndërmarrja e Re “Sharrcem” është duke zhvilluar aktivitetin në përputhje me kushtet e kontratës. Ndërmarrja e Re “Sharrcem” është e obliguar ti Raportoij AKP deri 09 Dhjetor 2015.

Ndërmarrja e Re “Remont Service”

është privatizuar në valën 45A, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar më 13 Qershor 2011. Kontrata e privatizimit për “Remont Service”, përmban kushtin për punësimin e 43 punëtorëve për një periudhë dy vjeçare – kusht i cili është transferuar nga kontrata e koncesionit në kontratën. Ndërmarrja e re “Remont Servisi” është një nga ndërmarrjet e privatizuara me kushte e cila deri me tani me mjaft sukses ka arritur të plotësoj kushtet e kontratës, blerësi i ndërmarrjes çdo tre mujor ka raportuar brenda afatit kohor të paraparë me kontratë dhe në disa raste ka raportuar se ka punësuar me shumë punonjës së sa ka qenë i obliguar sipas kushtit të kontratës për punësim. Gjatë vitit 2013 Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Me datën 21 nëntor të vitit 2013 Bordi i AKP-së ka marrë vendim për lirin e kësaj ndërmarrje nga monitorimi i kushteve të kontratës pasi që blerësi në mënyrë të kënaqshme ka përmbushur zotimet e marra përsipër.

Ndërmarrja e Re "Llamkos Steel" Sh.p.k.

Ndërmarrja e Re "Llamkos Steel" Sh.p.k, është privatizuar në valën 6 të shitjes përmes Likuidimit, ndërsa ratifikimi i Kontratës së Shitjes është bërë me datën 25 Gusht 2011. Bazuar në Marrëveshjen e Shitblerjes se aseteve dhe Planin e Biznesit, blerësi i Ndërmarrjes së re Llamkos ka marrë përsipër që të punësoj 437 punonjës 6 muaj pas nënshkrimit të kontratës si dhe të bëjë investime në vlerë prej 25 mil Euro vetëm gjatë dy viteve të para të veprimtarisë.

Blerësi i ndërmarrjes gjithashtu merr përsipër të zbatoj edhe dy faza të tjera investimesh, gjatë fazës së dytë (18 muaj pas përfundimit të fazës së parë) do të investohen edhe 45 mil Euro ndërsa gjatë fazës së tretë (18 muaj pas përfundimit të fazës së dytë) do të investohen edhe 30 mil Euro të tjera.

Gjatë vitit 2013 Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Gjendja në Ndërmarrja e re "Llamkos" është relativisht e mirë ndërmarrja është duke vazhduar aktivitetin prodhues. Megjithatë duhet të theksohet se reparti për galvanizimin e llamarinës ende është jashtë funksionit ndërsa në anën tjetër reparti për përpunimin e llamarinës (reparti për prodhimin kontejnerëve për mbeturina të madhësive të ndryshme, gypave për ajrosje etj) gjatë tërë kohës ka punuar me kapacitet të shtuar për shkak të kërkesave të mëdha në treg për këto produkte. Lidhur me punësimin e realizuar blerësi ka raportuar se vazhdon të realizoj punësim në pajtim me kushtet e kontratës që do thotë se ka punësuar 437 punëtorë me orar të plotë. Gjithashtu për të verifikuar përmbushjen e zotimeve për investime tek kjo ndërmarrje është angazhuar Kompania Audituese,, Grant Thornton".

Raporti i radhës për investime dhe punësim pritët të pranohet me 25 Gusht 2014.

Raporti për vazhdim të aktivitetit 25 Shkurt 2014.

Ndërmarrja e Re "Llamkos" është e obliguar ti raportoj AKP-së deri 25 Gusht 2016.

Ndërmarrja e Re "Famipa"

Ndërmarrja e Re "Famipa" sh.p.k, është privatizuar në valën 49 të shitjeve, ndërsa Kontrata e Shitblerjes është nënshkruar me datën 13 Shtator 2011.

Shtojca 5 – Seksioni B i Deklaratës së bartjes të aseteve dhe detyrimeve parasheh që blerësi i Ndërmarrjes së Re "Famipa" do të vazhdoj aktivitetin e njëjtë në ndërmarrje (prodhimin dhe përpunimin e metaleve) si dhe nuk do të çmontoj dhe dislokoj pajisjet nga ndërmarrja

të paktën deri në përfundim të kontratës.

Gjatë vitit 2013 Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Bazuar në atë çfarë kemi parë gjatë vizitave monitoruese gjendja në Ndërmarrjen e Re "Famipa" ka qenë jo e kënaqshme sepse blerësi ka pas vështirësi në plotësimin e kushtit të kontratës lidhur me vazhdimin e aktivitetit në ndërmarrje edhe pse blerësi është duke bërë përpjekjet për depërtim në tregjet tjera ngase nevojat për prodhime të tyre në tregun e Kosovës janë shumë të vogla.

Ndërmarrja e Re "Famipa" ka dorëzuar raportin e katërt 6 mujor me datën 06 Shtator 2013. Ndërsa raporti i radhës pritët të pranohet pas datës 13 Mars 2014.

Ndërmarrja e Re "Famipa" është e obliguar ti raportoj AKP deri 13 Shtator 2014.

Ndërmarrja e Re "Hotel Union"

Ndërmarrja e Re Hotel Union është privatizuar në valën 11, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 02 Gusht 2006. Bazuar në Marrëveshjen e Zotimeve 541/2006, neni 2 dhe 3 blerësi i Ndërmarrjes së Re është zotuar së do të restauroj dhe mirëmbajë pamjen e jashtme të ndërtesës në atë mënyrë që thellësisht do të ruaj stilin dhe karakterin historik të ndërtesës si dhe ti siguroj Aleancës së Shkrimtarëve të Kosovës një hapësirë prej 200 m2 për 13 vitet e ardhshme. Pas rinovimit të funksionalizimit të objektit të ndërmarrjes AKP-ja ka organizuar një takim me blerësin e Ndërmarrjes së Re "Hotel UNION" dhe përfaqësuesit e LSHK për qëllim të përcaktimit të lokacioni prej 200m2 që do ti jepet në shfrytëzim LSHK-s ashtu siç është përcaktuar me marrëveshjen e zotimeve. Gjatë këtij takimi nuk është arritur marrëveshja për këtë lokacion ngase blerësi kërkonte që ky lokacion të jete jashtë hapësirave të Hotel Unionit kurse përfaqësuesit e LSHK kërkonin që ky lokacion të jete brenda hapësirave të Hotel Unionit. Megjithatë përfaqësuesit e dy palëve kanë rënë dakord që të punojnë bashkarish në gjetjen e një zgjedhje të pranueshme për dy palët. Deri me tani nuk kanë arritur të gjejnë gjuhe të përbashkët dhe takimin e radhës që pritët të mbahet në fund të janarit 2014 shpresojmë që palët të merren vesh rreth kësaj hapësire.

Ndërmarrja e Re „ Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit ” Pejë:

është privatizuar si projekt individual përmes tenderit ndërkombëtarë ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 22 prill 2013. Bazuar në shtojcën 1, Marrëveshja për Zotime e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve

të thjeshta në Ndërmarrjen e Re “Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit” shpk, blerësi është zotuar si në vijim: Të vazhdoj aktivitetin aktual të biznesit që nënkupton vazhdimin e veprimtarisë së njëjtë të Ndërmarrjes Shoqërore në banjë shëndetësore dhe hotel. Blerësi i ndërmarrjes së re siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së zotimit

Gjatë vitit 2013 Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Ndërmarrja ka vazhduar të ushtroj veprimtarinë e biznesit ashtu siç është zotuar me kontratë, ndërsa në anën tjetër me mjaft intensitet po punohet në rregullimin e infrastrukturës dhe ngritjen e kapaciteteve të reja për akomodim. Sa i përket ndërtimeve të reja të gjitha punët e vrazhda janë kryer dhe tani po punohet në rregullimin e hapësirave të brendshme si instalimi i rrymës, ujit, ngrohjes dhe punë të tjera. Me datën 22 Tetor 2013 blerësi i ndërmarrjes ka dorëzuar raportin e parë 6 mujor. Bazuar në të dhënat e prezantuara në raportin 6 mujor blerësi gjatë tërë periudhës ka qenë në përputhje me kushtet e kontratës dhe për asnjë moment nuk ka ndërprerë veprimtarinë. Në anën tjetër blerësi ka raportuar se gjatë periudhës 6 mujore ka punësuar çdo muaj mesatarisht 134 punëtorë me orar të plotë. Po ashtu lidhur me investimet e realizuara gjatë periudhës raportuese blerësi ka raportuar se ka investuar gjithsej 1.019.614,25€.

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve”

është privatizuar në valën 45A, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar më 31 Mars 2011. Ndërmarrja e Re “Fabrika e Amortizatorëve” gjendet në Komunën e Prishtinës. Në bazë të marrëveshjes, si detyrim kontraktues blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe mbaj aktivitetin aktual të biznesit. Deri më tani janë bere 16 vizita monitoruese nga te cilat munde te përfundojmë se ndërmarrja zhvillon aktivitetin prodhues sipas kërkesave individuale por jo edhe ndonjë prodhim serik te amortizatorëve .

Periudha e Monitorimit përfundon me 31 Mars 2016.

Ndërmarrja e Re „Emin Duraku Kompleksi Industrial”

është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 03 Shtator 2012. Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Kompleksi Industrial” Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri

më 03 Shator 2017. Deri me tani kemi bere 12 vizita monitoruese nga të cilat shihet se Blerësi ka bërë lëvizje pozitive dhe ka lëshuar në prodhim linjën e tekstilit. Ne baze te marrëveshjes se shitjes Ndërmarrja ne vitin e parë duhet të raportoj çdo tre muaj, ndërsa gjatë viteve të tjera çdo gjashtë muaj.

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” Shpk

është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 14 Gusht 2012. Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 14 Gusht 2017. Gjatë kësaj periudhe duhet të raportoj tek Njësia e Kontrollit dhe mbikëqyrjes çdo gjashtë muaj. Deri me tani kemi zhvilluar 12 vizita monitoruese, ku mund te theksojmë se blerësi ka filluar aktivitetin ne ndërmarrje në fushën e tekstilit dhe ka lëshuar në funksion linjën e tekstilit.

Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm”

është privatizuar në valën e 28 –të të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 19 Dhjetor 2011. Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” gjindet në Komunën e Istogut. Në bazë të Marrëveshjes, si detyrim kontraktues blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së detyrimit kontraktues, respektivisht deri më 19 Dhjetor 2016, (periudha prej 5 viteve). Detyrimi kontraktues që del nga kontrata është që Ndërmarrja e Re “Dubrava Dairy Farm” është e obliguar të mbaj të punësuar 17 punëtor, si dhe të mbaj 250 krerë gjedhe për këtë periudhë kohore në bazë të kontratës. Bazuar në raportet gjashtëmujore, blerësi ka investuar në blerjen e 250 krerë gjedheve dhe ka punësuar 17 punëtorë në bazë të kontratës. Deri më tani janë bere dymbëdhjetë vizita monitoruese.

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça”

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça” Sh.p.k, është privatizuar si projekt individual, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 14 Qershor 2013. Me këtë blerësi i ri siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së Zotimit për tri vitet e ardhshme, konkretisht deri më 14 Qershor 2016. Deri më tani janë realizuar 6 vizita monitoruese, ku shihet se blerësi i ri është duke bërë përpjekje që të mbaj vazhdimin e aktivitetit, bazuar në Marrëveshjen e Zotimeve.

Raportin e pare gjashtëmujor blerësi i ri është i obliguar të e dorëzoj në muajin Janar 2014.

Ndërmarrja e Re “Rilindja Zona Industriale” Sh.p.k.

është privatizuar si Spin-Off në valën e 56, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 08 Nëntor 2013. Bazuar në nenin 2, të Marrëveshjes së Zotimeve, e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve të thjeshta në Ndërmarrjen e Re “Rilindja Zona Industriale” Sh.p.k, Blerësi është zotuar si në vijim:

- Siguron dhe garanton se do të mbajë të punësuar 110 (njëqind e dhjetë) punëtor me orar të plotë gjatë periudhës së Zotimit, periudhë kjo e cila hyn në fuqi nga data 08 Nëntor 2013 dhe do të zgjasë 60 ditë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së shitjes, konkretisht deri më 08 Janar 2014.

Deri me tani janë zhvilluar dy vizita monitoruese dhe ndërmarrja ka dorëzuar një raport mujor mbi punësimin.

NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIE ME INVESTITOR

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor gjatë vitit 2013 ka vazhduar të siguroj përkrahje të plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga AKP-ja si dhe menaxhimin e raporteve të mira me investitorët. Në aspektin e realizimit të shpalljes së shitjeve janë zhvilluar dhe zbatuar plane multi-mediale marketingu, përfshirë përdorimin e mjeteve të duhura mediale, në përputhje me strategjinë për marketing masiv. Janë ndërmarrë aktivitete operacionale që përfshijnë lansimin e shitjeve, realizimin e materialeve të duhura promovuese si dhe janë ofruar shërbime këshilluese për të gjithë investitorët e interesuar të marrin pjesë në procesin e Privatizimit dhe të likuidimit: informimin e tyre, parakualifikimin, koordinimin e hulumtimit paraprak etj.

Me qëllim të ngritjes së vizibilitetit dhe shpërndarjes së informatës tek publiku i gjerë dhe palët e interesit, si dhe promovimit të procesit të privatizimit tek investitorët potencial lokal dhe ndërkombëtar, Njësia e Marketingut ka përfaqësuar AKP-në në ngjarje dhe aktivitete relevante si dhe ka hulumtuar dhe identifikuar mundësitë e reja alternative për promovimin e punës së Agjencisë.

Iniciativat e Reja të Marketingut

- o Me qëllim të ngritjes së vizibilitetit dhe shpërndarjes së informatës tek publiku i gjerë dhe palët e interesit, si dhe promovimit të procesit të privatizimit tek investitorët potencial lokal dhe ndërkombëtar, Njësia e Marketingut ka krijuar kontakte dhe ka lidhur marrëveshje për të shfrytëzuar hapësirat promovuese të disa revistave të specializuara vendore, përfshirë revistat e specializuara për ekonomi dhe biznes si IP Magazina dhe revista Ekonomia. Gjithashtu është lidhur marrëveshje për promovimin e privatizimit përmes broshurës promovuese e publikuar nga Kosovo American Education Fund (KAEF).
- o Video udhëzuesi për aplikim të 20% dhe për dorëzimin e ankesave është realizuar, në përputhje me qëllimin e AKP-se për qasje më të lehtë në informata relevante për palët e interesit. Kjo video ju është shpërndarë palëve të interesuara dhe është vendosur në faqen e internetit të Agjencisë.
- o Si rezultat i hulumtimeve për identifikimin e metodave alternative për marketing, në përputhje me zhvillimet e fundit teknologjike, shpallja e Shitjeve është bërë edhe në media elektronike, me ç'rast janë përzgjedhur shtatë (7) portale më të vizituara për shpallje të shitjeve si dhe promovim të Agjencisë
- o Posterë për Panaire – janë përgatitur poster të rinj njoftues të cilët janë përdorur në panaire. Postarët e tillë kanë mundur identifikimin më të lehtë të pronave /lokaleve për palë e interesuara dhe njëkohësisht ka shërbyer si mjet promovues për Agjencionin.

Aktivitetet tjera marketingu

Në mbështetje të strategjisë për promovimin dhe tërheqjen e investitorëve ndërkombëtar, rajonal dhe lokal, njësia e Marketingut ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme marketingu:

- o Realizimi i materialeve të shtypura promovuese - përfshirë konceptimin, dizajnin dhe mbikëqyrjen e shtypit, si dhe ka bërë koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës së operatorit ekonomik në lidhje me materiale të realizuara jashtë Agjencisë.
- o Gjatë vitit 2013 përfaqësues të Njesisë kanë marrë pjesë në ngjarje të ndryshme, me qëllim të promovimit të procesit të privatizimit në përgjithësi, si dhe projekteve specifike në veçanti, përfshirë:
 - Panairi Citizen Information Fair (CIF), 17 prill – 19 prill 2013, Prishtinë
 - Panairi i Produkteve Bujqësore organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës 02,03,04,05 tetor 2013
- o Dizajni dhe editimi i nëntëmbëdhjetë (19) shpalljeve/njoftimeve për gazeta lokale dhe webfaqe
- o Realizimi i shtatë (7) TV reklama, respektivisht mbikëqyrja e realizimit të tre (3) TV reklamave dhe konceptimi, dizajni dhe realizimi i katër (4) TV reklamave
- o Analiza dhe shqyrtimi kualitativ i informatave rreth Ndërmarrjeve të Reja të privatizuara deri me tani, identifikimi i informatave shtese që nevojiten në mënyrë që të mund të bëhet një interpretim kuptimplote i raportit. Takimi inicial është realizuar me Ministrinë e Financave – Departamenti i Makroekonomisë, në lidhje me bashkëpunimin e mundshëm për realizimin e analizës së efekteve të privatizimit, ku janë shqyrtuar mundësitë reale rreth këtij bashkëpunimi. Fillimisht do të fillohet me analiza konkrete, (si efekti i shpërndarjes së 20%) dhe do të shikohen mundësitë reale për realizimin e një projekti të tillë. Ky projekt mendohet të vazhdohet gjatë 2014.

Shpallja e Valëve 57, 58 & 59 dhe Shitjeve të Aseteve 19, 20, 21, 22 & 23

Në kuadër të aktiviteteve mbështetëse për shpalljen e shitjeve janë ndërmarrë veprimet si në vijim:

- Përmbledhja e materialeve relevante, koordinimi me zyret rajonale dhe Njësine për Përgatitjen e Tenderëve në lidhje me përgatitjen e shpalljeve për Valë dhe Shitje të Aseteve
- Publikimi i shpalljeve të Shitjeve është bërë në të gjitha gazetatat lokale, uebfaqen e AKP-së dhe përmes transmetimit të TV Reklamës në tri Televizionet Kombëtare RTK, RTV 21, KTV. Njoftime të shkurtëra gjithashtu janë publikuar rreth afateve për para-kualifikim dhe datave për dorëzimin dhe hapjen e tenderëve.
- Investitorët e parakualifikuar janë njoftuar mbi shpalljen e Valëve dhe Shitjeve të Aseteve edhe përmes postës elektronike dhe SMS shërbimit.
- Për herë të parë këtë vit është zbatuar publikimi i shpalljeve edhe në mediet elektronike, me ç'rast janë përzgjedhur shtatë (7) portale më të vizituara.

MARRËDHËNIE ME INVESTITOR

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor vazhdon të mbetet pika primare e komunikimit me investitorët potencial lokal dhe ndërkombëtar, duke u përgjigjur kërkesave dhe ofruar udhëzime dhe këshillime rreth procesit të privatizimit dhe pjesëmarrjes në tenderët e shpallur, përfshirë parakualifikimin, koordinimin e hulumtimit paraprak dhe sigurimin e materialeve tenderuese (Rregullat e Tenderit, Memorandume Informimi etj.). Gjatë vitit 2013 janë realizuar takime të vazhdueshme me të gjithë investitorët e interesuar, që kanë rezultuar me:

- o 441 investitorë të rinj të parakualifikuar gjatë vitit 2013
- o Mbi 2,100 marrëveshje për ruajtjen e sekretit afarist të nënshkruara me palët e interesuara për pronat dhe asetet e tenderuara gjatë këtij viti

Web faqja

Njësia e Marketingut ka populluar uebfaqen e AKP-së me të gjitha informatat në lidhje me procesin e privatizimit në Kosovë. Kjo ka përfshirë lansimin e Valëve të Privatizimit dhe Shitjes së Aseteve, listat preliminare dhe finale të punëtorëve për shpërndarjen e 20%, raporteve përfundimtare të likuidimit, komunikatave për media, raporteve dhe rregulloreve, rezultateve dhe vendimeve për shitjet e asetëve, si dhe informatave të tjera të rëndësishme.

Në bazë të dhënave historike, numri i vizitave të uebfaqes ka një ngritje të vazhdueshme, ku për vitin 2013 janë regjistruar 311,584 vizita (nga 243,897 sa kanë qenë gjatë 2012).

DIVIZIONI PËR KOORDINIM TË LIKUIDIMIT

Divizioni i Likuidimit është njëra prej dy shtyllave të AKP-së i cili merret me procesin e likuidimit të NSH-ve. Divizioni i Likuidimit koordinon punët dhe detyrat në mes Zyrës Qendrore dhe Departamentit të Likuidimit së bashku me udhëheqësit e ekipeve të likuidimit në zyrat rajonale të AKP-së. Pas procedurave të tenderimit dhe nënshkrimit të kontratës më datë 10 korrik 2012 është angazhuar konzorciumi Deloitte dhe Tashko&Pustina për projektin “Ofrimi i Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës”, kontratë e cila menaxhohet nga Departamenti i Likuidimit, në kuadër të Divizionit të Likuidimit.

Departamenti për Koordinim të Likuidimit përbëhet nga këto njësi:

1. NJËSIA E MONITORIMIT TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA
2. NJËSIA E LIKUIDIMEVE NGA AKP-JA
3. NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE

NJËSIA PËR MONITORIM TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA

Fillimi i procedurave të likuidimit për ndërmarrjet e reja

Gjatë periudhës raportuese (01 janar – 31 dhjetor 2013), kanë filluar procedurat e likuidimit për 161 Ndërmarrje Shoqërore ku janë emëruar edhe Autoritetet e Likuidimit përkatëse për këto ndërmarrje nëpër Zyrat Rajonale (ZR) përkatëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Me fillimin e procedurave të likuidimit janë bërë njoftimet për kreditorët nëpër gazeta në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi, ashtu siç është e paraparë me Ligjin. Gjithashtu Autoritetet e Likuidimit kanë dërguar njoftim tek kreditorët e njohur për fillimin e procedurave të likuidimit si dhe kanë filluar me shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve brenda afateve ligjore.

Për 101 Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) tashmë është mbyllur afati për parashtrimin e kërkesave ndërsa 60 Ndërmarrje Shoqërore të tjera vazhdojnë të jenë në proces të pranimit të kërkesave.

*** Lista e ndërmarrjeve që kanë filluar likuidimin gjatë periudhës raportues - në vitin 2013**

Nr.	Nr. i ID AKP	EMRI I NDËRMARRJES	RAJONI	DATA E FILLIMIT TË LIKUIDIMIT
1	GJI036	N.H.H.I MORAVA E BINQËS	GJILAN	3 QERSHOR 2013
2	PEJ130	N.H.T RUGOVA	PEJË	3 QERSHOR 2013
3	PEJ019	K.B MORONICA	PEJË	3 QERSHOR 2013
4	PEJ031	K.B DOBRUSHA	PEJË	3 QERSHOR 2013
5	PRN090	DRITHNAJA	PRISHTINË	3 QERSHOR 2013
6	MIT015	EXTRA	MITROVICË	3 QERSHOR 2013
7	PRZ038	DARDANIA	PRIZREN	3 QERSHOR 2013
8	PRZ024	FAMIPA	PRIZREN	3 QERSHOR 2013
9	PRZ071	MALISHEVA	PRIZREN	3 QERSHOR 2013
10	GJI058	FABRIKA E BATERIVE	GJILAN	11 QERSHOR 2013
11	PRN144	KB LIRIA	PRISHTINË	11 QERSHOR 2013
12	PEJ095	AGIMI MISHI	PEJË	11 QERSHOR 2013
13	PEJ061	NDËRTIMTARIA - DEÇAN	PEJË	11 QERSHOR 2013
14	PRZ037	KORITNIK	PRIZREN	11 QERSHOR 2013
15	PRZ041	LIRIA	PRIZREN	11 QERSHOR 2013
16	PRZ051	SHOQATA AUTOMOTO	PRIZREN	11 QERSHOR 2013
17	MIT040	SHALA	MITROVICË	11 QERSHOR 2013
18	MIT016	BETONJERKA	MITROVICË	11 QERSHOR 2013
19	MIT049	FABRIKA E DUHANIT	MITROVICË	11 QERSHOR 2013

20	GJI011	PASURIA BUJQËSORE	GJILAN	19 QERSHOR 2013
21	PRN109	28 NËNTORI	PRISHTINË	19 QERSHOR 2013
22	PEJ088	FABRIKA E ELEMENTEVE METALIKE	PEJË	19 QERSHOR 2013
23	PEJ092	DEVA	PEJË	19 QERSHOR 2013
24	PRZ042	PRIZRENMARKET	PRIZREN	19 QERSHOR 2013
25	PRZ034	IFS PROGRES	PRIZREN	19 QERSHOR 2013
26	PRZ008	MIRUSHA	PRIZREN	19 QERSHOR 2013
27	MIT060	STACIONI I VETERINARISË- VUSHTERRI	MITROVICË	19 QERSHOR 2013
28	MIT075	RUZHDI BYTYQI	MITROVICË	19 QERSHOR 2013
29	MIT101	JUGOBANKA	MITROVICË	19 QERSHOR 2013
30	GJI096	17 NËNTORI	GJILAN	27 QERSHOR 2013
31	PRN047	AMORTIZATORËT	PRISHTINË	27 QERSHOR 2013
32	PEJ049	OSDRIM	PEJË	27 QERSHOR 2013
33	PEJ053	VITOMIRICA	PEJË	27 QERSHOR 2013
34	PRZ001	INDUSTRIA USHQIMORE	PRIZREN	27 QERSHOR 2013
35	PRZ067	KB BASHKIMI	PRIZREN	27 QERSHOR 2013
36	MIT037	TREPÇA HOTELERIA	MITROVICË	27 QERSHOR 2013
37	MIT093	STACIONI I VETERINARISË - ZUBIN POTOK	MITROVICË	27 QERSHOR 2013
38	MIT095	STACIONI VETERINARISË - LEPOSAVIQ	MITROVICË	27 QERSHOR 2013
39	MIT120	URBANIZMI	MITROVICË	27 QERSHOR 2013
40	MIT039	NSHT LUX	MITROVICË	19 GUSHT 2013
41	PRN088	LLAPI	PRISHTINË	19 GUSHT 2013
42	PRN100	RILINDJA- TREGTARE LIBRARE	PRISHTINË	19 GUSHT 2013
43	PEJ134	NT AGIMI	PEJË	19 GUSHT 2013
44	PEJ109	TREGJET	PEJË	19 GUSHT 2013
45	PEJ138	NSHT "KLINA"	PEJË	19 GUSHT 2013
46	PRZ045	25 MAJI	PRIZREN	19 GUSHT 2013
47	PRZ018	UNIMONTI	PRIZREN	19 GUSHT 2013
48	GJI059	JUGOTERM	GJILAN	19 GUSHT 2013
49	GJI029	KB BUJKU	GJILAN	19 GUSHT 2013
50	GJI034	KB VITIA	GJILAN	19 GUSHT 2013

51	MIT042	ÇYÇAVICA	MITROVICË	26 GUSHT 2013
52	PRN003	REMONT	PRISHTINË	26 GUSHT 2013
53	PRN114	RILINDJA SHITJA	PRISHTINË	26 GUSHT 2013
54	PRN162	KB KOMORAN	PRISHTINË	26 GUSHT 2013
55	PEJ089	FPA "ZASTAVA – RAMIZ SADIKU"	PEJË	26 GUSHT 2013
56	PEJ014	NTP PRODUKT	PEJË	26 GUSHT 2013
57	PEJ045	KB DRELAJ RUGOVË	PEJË	26 GUSHT 2013
58	PRZ050	PRIZRENCOOP	PRIZREN	26 GUSHT 2013
59	GJI012	PLANTACIONI	GJILAN	26 GUSHT 2013
60	GJI105	NSHT SHARR	GJILAN	26 GUSHT 2013
61	GJI044	TULLARA (CIGLANA)	GJILAN	26 GUSHT 2013
62	PRN046	FAN ZAHIR PAJAZITI	PRISHTINË	2 SHTATOR 2013
63	PRN005	QUMSHTORJA KONZUME	PRISHTINË	2 SHTATOR 2013
64	PRN015	KB DRITA	PRISHTINË	2 SHTATOR 2013
65	PEJ110	EMIN DURAKU	PEJË	2 SHTATOR 2013
66	PEJ137	NT "KORRENİK"	PEJË	2 SHTATOR 2013
67	PEJ131	NSHT "16 QERSHORI"	PEJË	2 SHTATOR 2013
68	PRZ044	NTSH PODRIMA RAHOVEC	PRIZREN	2 SHTATOR 2013
69	GJI104	NTSH MORAVA E EPËRME	GJILAN	2 SHTATOR 2013
70	GJI077	SHAM DRITA	GJILAN	2 SHTATOR 2013
71	GJI167	JOMETALET KAOLINI	GJILAN	2 SHTATOR 2013
72	PRN113	IMB MULLIRI	PRISHTINË	9 SHTATOR 2013
73	PRN020	KB SHTIME	PRISHTINË	9 SHTATOR 2013
74	PRN014	KB BESA	PRISHTINË	9 SHTATOR 2013
75	PEJ003	KB BEC	PEJË	9 SHTATOR 2013
76	PEJ153	NTP RADUSHA	PEJË	9 SHTATOR 2013
77	PEJ140	NT AGRODUKAGJINI	PEJË	9 SHTATOR 2013
78	PRZ002	KOSOVA VERA	PRIZREN	9 SHTATOR 2013
79	GJI033	ZADRUGA SHTËRPCE	GJILAN	9 SHTATOR 2013
80	GJI169	PARTIZAN BABUSH	GJILAN	9 SHTATOR 2013
81	GJI001	MINEX	GJILAN	9 SHTATOR 2013

82	PRN078	YUMCO	PRISHTINË	16 SHTATOR 2013
83	PRN068	BARNATORET E PRISHTINËS	PRISHTINË	16 SHTATOR 2013
84	PRN051	SEPARACIONI I GURËVE GADIME	PRISHTINË	16 SHTATOR 2013
85	PEJ173	KOMBINATI I LËKURË KËPUCËVE	PEJË	16 SHTATOR 2013
86	PEJ068	NNIT MIRUSHA	PEJË	16 SHTATOR 2013
87	PEJ098	STACIONI I VETERINËS "VETERINA"	PEJË	16 SHTATOR 2013
88	PRZ019	ZDRUKTHËTARIA	PRIZREN	16 SHTATOR 2013
89	GJI007	KB FERIZAJ	GJILAN	16 SHTATOR 2013
90	GJI067	NSH BENTOKOS	GJILAN	16 SHTATOR 2013
91	GJI150	STACIONI I VETERINËS "KAÇANIK"	GJILAN	16 SHTATOR 2013
92	PRN045	FABRIKA E VENTILATORËVE -TERMOVENT	PRISHTINË	23 SHTATOR 2013
93	PRN053	MINIERA DHE INDUSTRIA E MAGNEZIT GOLESHI	PRISHTINË	23 SHTATOR 2013
94	PRN099	NTSH PASHTRIKU	PRISHTINË	23 SHTATOR 2013
95	PEJ104	NSHMA DUKAGJINIREMONT	PEJË	23 SHTATOR 2013
96	PEJ150	MODELI	PEJË	23 SHTATOR 2013
97	PEJ052	KB DRITA "RAUSHIQ"	PEJË	23 SHTATOR 2013
98	PRZ059	KOOPERIMI	PRIZREN	23 SHTATOR 2013
99	GJI002	FABRIKA E VAJIT	GJILAN	23 SHTATOR 2013
100	GJI170	NDËR.RE. XIM STREZOCI	GJILAN	23 SHTATOR 2013
101	PRN129	INGENERING	PRISHTINË	19 GUSHT 2013
102	PRN102	TREGTIA E KOSOVËS	PRISHTINË	19 GUSHT 2013
103	GJI017	KB MALISHEVA	GJILAN	16 DHJETOR 2013
104	GJI097	TREGTIA	GJILAN	16 DHJETOR 2013
105	MIT061	KB BANJSKA	MITROVICË	16 DHJETOR 2013
106	PEJ033	KB BURIMI - VRELLË	PEJË	16 DHJETOR 2013
107	PEJ040	UJËMIR	PEJË	16 DHJETOR 2013
108	PEJ050	KB POQESTA	PEJË	16 DHJETOR 2013
109	PEJ054	KB ZAHAQI	PEJË	16 DHJETOR 2013
110	PRN016	KB DUMNICA	PRISHTINË	16 DHJETOR 2013
111	PRN063	KOSOVARJA ARTIZANATI	PRISHTINË	16 DHJETOR 2013
112	PRN087	BLINAJA	PRISHTINË	16 DHJETOR 2013

113	PRZ031	REMONT SERVIS	PRIZREN	16 DHJETOR 2013
114	PRZ047	PRIZREN TRANS	PRIZREN	16 DHJETOR 2013
115	GJI013	KB "1 MAJI"	GJILAN	2 DHJETOR 2013
116	GJI022	KB SHURDHANI	GJILAN	2 DHJETOR 2013
117	GJI086	KOSOVARJA	GJILAN	2 DHJETOR 2013
118	PEJ015	PRODHIMTARIA BIMORE IZNIQ	PEJË	2 DHJETOR 2013
119	PEJ044	KB BARAN	PEJË	2 DHJETOR 2013
120	PEJ106	MOFAST	PEJË	2 DHJETOR 2013
121	PEJ146	GJERAVICA	PEJË	2 DHJETOR 2013
122	PEJ197	BARNATORET E GJAKOVËS	PEJË	2 DHJETOR 2013
123	PRN106	KOSOVA SHPED	PRISHTINË	2 DHJETOR 2013
124	PRN128	INSTITUTI PËR HIDROEKONOMI	PRISHTINË	2 DHJETOR 2013
125	PRN157	FABRIKA PËR PRODHIMIN E KËRPUDHAVE	PRISHTINË	2 DHJETOR 2013
126	PRZ074	KB RATKOC	PRIZREN	2 DHJETOR 2013
127	GJI148	STACIONI I VETERINËS-KAMENICË	GJILAN	23 DHJETOR 2013
128	MIT054	KB ZUBIN POTOK	MITROVICË	23 DHJETOR 2013
129	PEJ017	PRAPAQANI	PEJË	23 DHJETOR 2013
130	PEJ035	KB GURAKOCI	PEJË	23 DHJETOR 2013
131	PEJ038	KB LIRIA	PEJË	23 DHJETOR 2013
132	PEJ042	KB LESHAN	PEJË	23 DHJETOR 2013
133	PEJ062	9 NËNTORI-GJAKOVË	PEJË	23 DHJETOR 2013
134	PEJ155	KB PËRPARIMI-IZNIQ	PEJË	23 DHJETOR 2013
135	PRN017	KB FLORA	PRISHTINË	23 DHJETOR 2013
136	PRN072	EUP ENGINEERING	PRISHTINË	23 DHJETOR 2013
137	PRN089	AGROKOSOVA	PRISHTINË	23 DHJETOR 2013
138	PRN096	MARKETING EXPORT	PRISHTINË	23 DHJETOR 2013
139	GJI004	AGROKULTURA	GJILAN	25 NËNTOR 2013
140	GJI008	KB BASHKIMI	GJILAN	25 NËNTOR 2013
141	GJI031	KB PËRPARIMI HOGOSHT	GJILAN	25 NËNTOR 2013
142	GJI149	STACIONI I VETERINËS -VITI	GJILAN	25 NËNTOR 2013
143	PEJ036	DUBRAVA	PEJË	25 NËNTOR 2013

144	PEJ037	KB BISTRICA	PEJË	25 NËNTOR 2013
145	PEJ060	F.B.I TREPÇA	PEJË	25 NËNTOR 2013
146	PEJ087	UNIMETAL	PEJË	25 NËNTOR 2013
147	PEJ187	KB NOVOSELLA	PEJË	25 NËNTOR 2013
148	PRN019	KB PËRPARIMI PODUJEVË	PRISHTINË	25 NËNTOR 2013
149	PRN143	KB FRYTI	PRISHTINË	25 NËNTOR 2013
150	PRZ073	KB PIRANA	PRIZREN	25 NËNTOR 2013
151	GJI014	KB BRESALCI	GJILAN	9 DHJETOR 2013
152	GJI045	XIQ KARAQEV	GJILAN	9 DHJETOR 2013
153	PEJ018	KB DEÇANI	PEJË	9 DHJETOR 2013
154	PEJ039	KB SHTUPEL	PEJË	9 DHJETOR 2013
155	PEJ046	KB GLOGJAN	PEJË	9 DHJETOR 2013
156	PEJ129	PEJATURIST	PEJË	9 DHJETOR 2013
157	PEJ194	BANJA E PEJËS	PEJË	9 DHJETOR 2013
158	PRN057	ENTI PËR PUNË GJOEDETE DHE FOTOGRAFIKE	PRISHTINË	9 DHJETOR 2013
159	PRN073	ENERGOMONTIMI	PRISHTINË	9 DHJETOR 2013
160	PRN163	KB MUZEQINA	PRISHTINË	9 DHJETOR 2013
161	PRZ030	NDËRTIMI	PRIZREN	9 DHJETOR 2013

PRANIMI DHE REZULTATET E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE NGA ANA E OSHP-KONTRAKTORIT

Në përputhje me Ligjin e ri Nr.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) është angazhuar konzorciumi "Deloitte dhe Tashko&Pustina" për projektin e Ofrimit të Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës (OSHP – Kontraktori).

Të gjitha Autoritetet e Likuidimit të emëruara për NSh-të të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit gjatë periudhës raportuese janë aktivizuar dhe kanë vazhduar me punët dhe detyrat e tyre sipas procedurave të likuidimit.

Deri më 31 dhjetor 2013 nga pretenduesit e ndryshëm janë dorëzuar rreth 25,720 kërkesa të cilat më pastaj janë përcjell në zyrat rajonale respektive për të

shqyrtuar.

Gjatë periudhës raportuese Autoritetet e Likuidimit të këtyre ndërmarrjeve kanë arritur që të bëjnë shqyrtimin dhe të dërgojnë 41,478 vendime tek pretenduesit të cilët kanë parashtruar kërkesa pranë Agjencisë. Autoritetet e Likuidimit (AL) të këtyre Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim kanë përgatitur edhe 10,802 draft vendime të cilat pas kalimit të procedurave të kontrollit të kualitetit edhe këto pritet që së shpejti të ju dërgohen palëve. Gjatë periudhës raportuese janë përgatitur edhe 5,533 kërkesa për informata shtesë të cilat janë dërguar te pretenduesit.

Tabela ilustruese

NUMRI I KËRKESAVE TË PRANUARA GJATË 2013	NUMRI I VENDIMEVE TË LËSHUARA NGA AL GJATË 2013	VLERE E KËRKESAVE TË PRANUARA NGA AL GJATË 2013	VLERE E KËRKESAVE TË REFUZUARA NGA AL GJATË 2013
25,720	41,478	63,000,000	306,000,000

Dallimi në mes të kërkesave kreditore të pranuar dhe vendimeve të lëshuara nga AL qëndron në faktin se NSH-të që janë vendosur në Likuidim gjatë fund vitit të kaluar, për shkak të afateve të përcaktuara ligjore, shqyrtimi i këtyre kërkesave kreditore është bërë gjatë periudhës raportuese.

Vlerat e pranuar e kërkesave nga AL -të në tabelën e më sipërme mund të jetë subjekt i ndryshimeve varësisht nga vendimet e marrura në ankesat e parashtrua në DhPGJSK.

Autoritetet e Likuidimit (AL) të këtyre Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim gjatë periudhës raportuese kanë përgatitur 22 Raporte për këto NSH (nga të cilat 6 janë raporte përfundimtare dhe 16 janë raporte për shpërndarje) të cilat i janë prezantuar Bordit të Drejtorëve të AKP-se për aprovim. Për 16 raportet e përfunduara të shpërndarjes, procesi është bllokuar si pasojë e mos emërimit të anëtarit të tretë nga ndërkombëtarët në Bordin e Agjencisë (këto raporte nuk mund të miratohen nga Bordi edhe rrjedhimisht pagesat ndaj kreditorëve të ligjshëm nuk mund të kryhen). Ndërsa për gjashtë raportet tjera përfundimtare AL-ja është në proces të dorëzimit të këtyre raporteve pranë DhPGJSK.

Gjatë kësaj periudhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) ka finalizuar 61 vendime, nga të cilat 60 janë në favor të vendimeve të AL-ve, ndërsa një vendim është kundër, vendim i cili është apeluar nga AL përkatës.

Po ashtu gjatë periudhës raportuese në DhPGJSK kanë pranuar afërsisht 2,559 ankesa kundrejt vendimeve të AL-ve, nga të cilat DhPGJSK ka kërkuar mbrojtje nga AL për 221 raste, duke rezultuar në 2,338 ankesa ende të pashqyrtuara nga DhPGJSK. Kjo shihet si një çështje problematike pasi që ndikon në vonesa në procesin e përmbylljes së likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

NJESIA E LIKUIDIMEVE NGA AKP

Bazuar në nenin 13 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, në rastet kur ndërmarrja shoqërore e cila është objekt i likuidimit nuk ka asnjë pasuri apo kundër së cilës nuk është parashtruar asnjë kërkesë kreditore në afat, atëherë në këto raste anëtarët e AL-së emërohen nga radhët e personelit të AKP-së, dhe i gjithë procesi i likuidimit të këtyre ndërmarrjeve realizohet nga Njësia përkatëse përbrenda agjencisë, gjegjësisht Njësia e Likuidimit të NSH-ve nga AKP-ja në kuadër të Departamentit për Koordinim të Likuidimit.

Gjatë periudhës raportuese 01 Janar - 31 Dhjetor 2013, në Njësine të Likuidimeve nga AKP-ja janë bartur 8 ndërmarrje shoqërore (pa asete ose pa kërkesa) për të cilat është punuar në procesin e përmbylljes së likuidimit

konform procedurave ligjore të parapara në Shtojcën e Ligjit të AKP-së Nr. 04/L-034.

Në vijim janë të listuara NSH-të për të cilat është punuar në procesin e përmbylljes së likuidimit:

- Kooperativa Bujqësore "Likovci" – Skenderaj
- Kooperativa Bujqësore "Liria" – Skenderaj
- Kooperativa Bujqësore "Klina" – Skenderaj
- ShAM "Semafori" – Suharekë
- Kooperativa Bujqësore "Ozdrim" – Pejë
- Kooperativa Bujqësore "Vitomirica" – Pejë
- NSh ShAM "Ruzhdi Bytyqi" – Vushtrri
- NSh "Auto Moto" – Prizren

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) ka aprovuar Raportet Përfundimtare të procesit të likuidimit dhe në të njëjtën kohë ka lejuar përmbylljen e procesit të likuidimit për 2 Ndërmarrje Shoqërore (pa asete ose pa kërkesa kreditore). Në vijim janë ndërmarrjet për të cilat është përmbyllur procesi i likuidimit:

EMRI I NDËRMARRJES	DATA E VENDIMIT TË DhPGJSK
